



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

---

# RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

**Janar - Dhjetor 2017**

Prishtinë, Mars 2018

## Përmbajtja

Akronimet .....	4
Hyrje.....	5
Qëllimi dhe metodologjia .....	5
Përmbledhje ekzekutive .....	6
1. Kuvendet e komunave .....	10
1.1. Funkzioni i Kuvendeve të Komunës.....	10
1.2. Konstituimi i Kuvendeve të Komunave .....	11
1.3. Komitetet e Përhershme, Komitetet Konsultative dhe Komitetet Tjera.....	12
1.3.1. Komitetet e Përhershme.....	12
1.3.2. Komitetet Konsultative .....	13
1.3.3. Komitetet Tjera .....	14
1.4. Raportimi i Kryetarit të Komunës.....	15
1.5. Takimet Publike me Qytetarë.....	16
1.6. Publikimi i Akteve në faqet elektronike të Komunave .....	17
1.7. Aktet Komunale.....	18
1.8. Shqyrtimi i Ligjshmërisë së Akteve Komunale .....	18
1.9. Veprimet për Harmonizim të Akteve të Kundërligjshme nga Komunitat.....	19
1.10. Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi .....	21
2. Agjenda Evropiane .....	23
2.1. Kriteret politike .....	23
2.1.1. Administrata publike .....	23
2.1.2. Avokati i popullit.....	26
2.1.3. Shoqëria Civile .....	27
2.1.4. Lufta Kundër Korrupsionit .....	27
2.1.5. Planet lokale për Integritet.....	28
2.1.6. Veprimet Kundër Luftës së Terrorizmit.....	28
2.1.7. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve .....	28
2.1.8. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore .....	30
2.2. Kriteret Ekonomike .....	31
2.2.1. Ekonomia e tregut.....	31
2.3. Standardet Evropiane .....	33

2.3.1. One Stop Shop.....	33
2.3.2. Gjyqësori dhe të Drejtat e njeriut .....	34
2.3.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria .....	37
2.3.4. Migracioni.....	37
2.3.5. Arsimi dhe Kultura.....	37
2.3.6. Mjedisi .....	39
2.3.7. Bujqësia Lokale.....	40
2.3.8. Bashkëpunimi Ndërkomunal dhe Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar .....	41
2.3.9. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik .....	41
3. Financat Lokale.....	42
3.1. Planifikimi i të Hyrave Vetanake.....	42
3.2. Realizimi i të Hyrave Vetanake .....	42
3.3. Buxheti Komunal për vitin 2017.....	42
3.4. Shpenzimet Krahasuar me Buxhetimin.....	42
3.5. Opinioni i Auditorit për Komunitet e Republikës së Kosovës.....	44
Përfundime të përgjithshme .....	46
Rekomandime .....	48
Literatura/burimet .....	53

## Akronimet

BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
KK	Kuvendi i komunës
KKSB	Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSP	Këshillat Lokal për Siguri Publike
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSA	Marrëveshja për Stabilizim Asociimit
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
OJQ	Organizatë e Shoqërisë Civile
PL	Pushteti Lokal
PQ	Pushteti Qendror
RAE	Rom, Ashkali dhe Egjiptas
VQL	Vetëqeverisja Lokale

## Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal harton rregullisht raportin për funksionimin e komunave, duke vlerësuar progresin e komunave drejt përmbushjes së obligimeve ligjore, zbatimin e kompetencave, si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësive që lidhen me realizimin e kërkesave dhe interesave të qytetarëve:

Ky raport ndjek këtë strukturë::

- Raporti përshkruan funksionimin e kuvendeve të komunave dhe ekzekutivit të komunës;
- Paraqet rezultatet e punës së organeve komunale, me theks të veçantë kuvendit të komunës si organi më i lartë në komunë;
- Analizon çështjet e transparencës komunale;
- Shqyrton hapat e komunave në zbatimin e obligimeve nga Programi Kombëtar për MSA;
- Paraqet të dhënat për planifikimin e buxheteve komunale, realizimin e të hyrave dhe shpenzimet buxhetore.

Raporti përfshinë periudhën Janar - Dhjetor 2017 dhe është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL

## Qëllimi dhe metodologjia

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, organizatave joqeveritare, qytetarëve dhe çdo grupi tjetër të interesit, lidhur me nivelin e funksionimit të komunave sipas mandatit ligjor që kanë. Përmes këtij raporti kemi pasqyruar një qasje të qartë lidhur me aktivitetet e organeve të komunave. Gjithashtu, raporti shërben si mjet për të rritur transparencën dhe efikasitetin e organeve të komunave.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të organeve të komunave, për vitin 2017. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë këtij viti, në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës.

Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

Lidhur me metodologjinë e raportit, ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura dhe të analizuara në procesin e monitorimit të komunave nga Departamentet (njësitë) përkatëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjithashtu, janë përdorur edhe burime të tjera, duke përfshirë përgjigjet e zyrtarëve komunal në pyetjet e parashtruara, Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit - MF, si dhe të dhënat e siguruar nga monitorimi i drejtpërdrejtë i komunave.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr konkluzione të detajuara lidhur me funksionimin e organeve komunale dhe hapave të cilët komunat duhet ndërmarrin komunat në të ardhmen.

## Përmbledhje ekzekutive

Funksionimi i kuvendeve të komunave - Gjatë vitit 2017 komunat kanë ushtruar funksioneve të tyre në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm dhe në përputhje me prioritetet e vendit të cilat dalin nga dokumentet kryesore strategjike, duke përfshirë këtu Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, strategjitë sektoriale, si dhe një pjesë të konsiderueshme të obligimeve të parapara në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Aasociimit – PKZMSA.

Bazuar në planifikimin vjetor për vitin 2017, kuvendet e komunave kanë zhvilluar rregullisht aktivitetet e tyre, kështu duke aprovuar edhe një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore. Sa u përket mbarëvajtjes së mbledhjeve, ato kanë qenë të hapura për qytetarët duke përfshirë edhe njoftimet me kohë për mbajtjen e punimeve. Përveç komunës së Junikut, Mamushës dhe Dragashit, të cilat në disa raste kanë pasur probleme teknike dhe nuk ka pasur mundësi për dërgimin e materialeve me kohë, kurse komunat: Partesh, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq në disa raste nuk kanë dërguar materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale.

Në përgjithësi, komunat kanë respektuar ligjet e aplikueshme me rastin e zhvillimit të aktivitetit normativ të tyre. Nga aspekti sasior, kuvendet kanë mbajtur 459 mbledhje, prej të cilave 323 mbledhje të rregullta, 52 të jashtëzakonshme, 43 solemne dhe 3 urgjente dhe 38 mbledhje të tjera inagruuese. Krahas kuvendeve, komitetet e obligueshme kanë funksionuar rregullisht duke shqyrtuar dokumentet financiare, planet, propozim-vendimet, projekt-rregulloret dhe çështjet e tjera politiko-financiare. Gjatë kësaj periudhe, Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 325 mbledhje, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 258 takime. Në kuvendet e komunave janë themeluar një numër i madh i komiteteve të tjera ndihmëse me gjithsej 62 Komitete, nga të cilët prijnë Komitetet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, arsim, kulturë dhe sport dhe Komiteti në fushën e urbanizmit. Krahas tyre, janë funksionale edhe 27 Komitete Konsultative në 7 komuna nga gjithsej 38 komuna, ku fokusi kryesor i këtyre Komiteteve ka qenë më shumë në fushën: e zhvillimit ekonomik, arsimit, kulturës, rinisë, sportit dhe shërbimeve publike.

Viti 2017 ka qenë po ashtu vit zgjedhor ku me datë 22 tetor 2017, janë mbajtur zgjedhjet lokale për 38 komuna. MAPL ka pasur një rol me rëndësi në bashkëpunimin me strukturat e zgjedhura për implementimin e rezultateve zgjedhore dhe konstituimin e organeve të reja të komunave. MAPL ka bërë monitorimin lidhur me respektimin e proceduarave ligjore për inaugurimin e organeve të komunave, duke filluar nga thirrja e mbledhjeve inauguruuese, dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarët e Komunave, si dhe themelimin e trupave funksionale të kuvendeve në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Monitorimi i këtyre mbledhjeve është bërë përmes sistemit të teleprezencës, me përjashtim të komunave: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok të cilat janë monitoruar me pjesëmarrje fizike të zyrtarëve të monitorimit. Mbledhjet inauguruuese janë mbajtur në të gjitha komunat, me ftesë nga kryetarët e zgjedhur. Në të gjitha komunat kanë dhënë betimin anëtarët e kuvendeve dhe kryetarët e komunave, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, respektivisht nenet 35.4 dhe 57.1 të këtij ligji. Edhe procedura e zgjedhjes së kryesuesve të kuvendeve të komunave ka qenë në përputhje me nenin 41 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Për të siguruar efikasitetin e ekzekutivit të komunës në zbatimin e politikave, kuvendet e komunave kanë kërkuar raportim të rregullt nga kryetarët e komunave dhe raportime të tjera shpesh. Sipas të dhënave, 28 kryetarë të komunave kanë përmbushur normën ligjore të raportimit të rregullt para kuvendeve të komunave për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë vitit 2017. Mirëpo është evidentuar se kryetarët e komunave Kllokot dhe Leposaviq nuk kanë raportuar asnjëherë, kurse kryetarët e komunave: Glllogoc,

Skenderaj, Klinë, Lipjan, Obiliq, Suharekë, Zveçan dhe Zubin Potok kanë raportuar vetëm nga një herë brenda periudhës raportuese duke mos e përmbushur obligimin ligjor sipas nenit 58 pika j) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Gjatë kësaj periudhe, komunat kanë shfrytëzuar mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në politikbërje, veçanërisht gjatë organizimit të takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë, por edhe konsultimeve publike gjatë procesit të hartimit të projekt-akteve komunale. Ligji për vetëqeverisje lokale kërkon që komunat të mbajnë së paku 2 takime gjithëpërfshirëse me qytetarë gjatë vitit. 22 komuna kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë. Për dallim nga to, Komuna e Klllokotit nuk ka mbajtur asnjë takim të tillë, ndërsa komunat: Novobërdë, Kaçaniku Glllogoc, Skenderaj, Gjakovë, Klinë, Istogu, Pejë, Prishtinë, Ferizaj, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore, Fushë Kosovë, Suharekë, Laposaviqi, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan, kanë mbajtur vetëm nga një takim publik me qytetarët, duke mos përmbushur kriterin minimal të përcaktuar me nenin 68.1 të LVL-së.

Sa i përket aktivitetit vendimmarrës, Kuvendet e komunave kanë qenë mjaft aktive në miratimin e akteve komunale dhe publikimin e tyre në ueb faqen zyrtare të komunës. Kuvendet e komunave kanë aprovuar 77 rregullore dhe 1328 vendime, apo në total 1405 akte. Nga ky numër i akteve të aprovuara, në ueb-faqet zyrtare të komunave janë 1261 të publikuara. Akte e miratuara janë të ndryshme dhe përfshirë: ato të natyrës financiare (miratimi i buxhetit, miratimi i kornizës afatmesme buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, akte për bartjen e mjeteve financiare nga viti fiskal paraprak në vitin 2017), mjedisore, ekonomike, arsimit, sociale, urbanistike etj. Numrin më të madh të rregulloreve e ka miratuar Kuvendi i Komunës së Graçanicës 7 rregullore i pasuar nga Komuna e Klinës dhe Istogut me nga 5 rregullore, derisa numrin më të madh të vendimeve Kuvendi i Komunës së Ferizajt gjithsej 105 vendime.

MAPL ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së 556 akteve, ndërsa në ministri të linjës janë dërguar 849 akte të komunave për vlerësim të ligjshmërisë. Gjatë monitorimit të komunave për vitin 2017, si dhe vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale nga MAPL janë konfirmuar të ligjshme 556 akte, ndërsa janë konstatuar 23 kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë. MAPL ka dërguar shkresat për rishqyrtim të ligjshmërisë, me ç'rast komunat i kanë harmonizuar 7 akte konform kërkesës për harmonizim. Në anën tjetër, 16 kërkesa për rishqyrtim të akteve ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës. Aktet e komunave të cilat kanë qenë të kundërligjshme dhe që janë harmonizuar nga komunat janë: Komuna e Istogut 1 shkelje të harmonizuar, Komuna e Glllogocit me 2 shkelje, komuna e Ferizajt me 3 shkelje dhe Komuna e Rahovecit me 1 shkelje ligjore. Ndërsa, komunat të cilat kanë pasur shkelje ligjore të pa harmonizuara gjatë vitit 2017 kanë qenë komunat: Fushë Kosovë me 1 shkelje ligjore, Glllogoc me 1, Shtime me 1, Lipjan me 2 shkelje, Klllokot me 2, Istog me 3 shkelje, Deçan me 2, Dragash me 3 shkelje dhe Graçanicë me 1 shkelje të pa harmonizuar. Gjithashtu, shqyrtimi i ligjshmërisë nga ministritë e linjës duhet të ndodhë brenda afateve ligjore, si dhe të shtohen përpjekjet për rishqyrtim dhe harmonizim të akteve të kundërligjshme nga komunat.

Këshillat për Siguri në Bashkësi - Në komuna ka vazhduar trajtimi i çështjeve të sigurisë nga ana e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi. Ky Këshill aktualisht është i themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunat: Laposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok. Për nga numri i takimeve, më aktiv ka qenë Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Hanit të Elezit me gjithsej 12 takime të mbajtura, 6 takime ka mbajtur KKSb në komunën e Ferizajt, Kaçanikut, Mitrovicës Jugore, Gjilanit dhe Shtërpçës, nga 5 takime KKSb ka mbajtur në Komunën e Dragashit, Obiliqit, Vushtrrisë, Klinës, Novobërdës, dhe Suharekës, nga 4 takime ky këshill ka mbajtur në Komunën e: Rahovecit, Vitisë, Podujevës, Pejës, Istogut, Lipjanit, nga 3 takime ka mbajtur në komunën e Malishevës, Deçanit, nga 2 takime ka mbajtur në komunat: Prizren, Junik, Ranillug, Partesh, Prishtinë, Skenderaj, Glllogoc dhe Gjakovë, 1 takim ka mbajtur

komuna e Mamushës, ndërsa Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka mbajtur asnjë takim në Komunën e Shtimes, Fushë Kosovës, Kamenicë, Kllokotit, dhe Graçanicës duke mos respektuar minimumin e paraparë për 6 takime sipas Udhëzimit Administrativ për KKSBB. Krahas tyre, shumica e KKSBB-ve të komunave të tjera janë brenda normës së paraparë ligjore për mbajtje të takimeve. Çështjet më të trajtuara gjatë periudhës raportuese rreth problemeve të sigurisë në bashkësi kanë qenë: trashëgimia kulturore, siguria në komunikacion, paraqitja e rasteve emergjente, mbarëvajtja e zgjedhjeve, përdorimi i narkotikëve nga të rinjtë, përgatitja për zgjedhje lokale, mbeturinat në rrugë, mungesa e trotuareve, nënkallimeve dhe shenjave sinjalizuese, gjendja e furnizimit me ujë të pijshëm gjatë sezonit veror, etj.

Implementimi i obligimeve nga MSA - Kosova tani ka hyrë në një kapitull të rëndësishëm të proceseve integruese me Bashkimin Evropian. Në pajtim me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) e cila ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016, si dhe Programin Kombëtar për zbatim të MSA-së të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 mars 2016, MAPL ka ndërmarrë veprime për adresimin dhe zbatimin e obligimeve të komunave në kuadër të tri kritereve kryesore (politike, ekonomike dhe standardet evropiane). Në mënyrë të veçantë janë përgatitur matricat individuale të komunave nga obligimet e agjendës evropiane, duke përfshirë: Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit dhe PKZMSA-në, dhe dokumente tjera relevante, mbi bazën e të cilave janë ofruar të dhëna në këtë kapitull.

Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2017 komunat kanë arritur t'i përmbushin 67% të aktiviteteve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 75% të kritereve dhe në fushën e standardeve evropiane, ato kanë realizuar 61% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2017 është 67%.

Financat lokale - Lidhur me performancën e komunave në menaxhimin e buxhetit, gjatë vitit 2017 përgjithësisht vërehet progres në këtë fushë. Kësisoj, planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2017 ka qenë në vlerë prej 78,163,490.00 €, për dallim nga viti 2016 sa ka qenë në vlerë prej 79,622,353.00 €, apo 1,458,863.00 më pak, ose për 1.83%. Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2017 ka qenë 72,529,276.75 €, që nëse krahasojmë me planifikimin, atëherë i bie se realizimi i të hyrave është 93%. Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2017 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 419,327,289.09 ose 90% nga vlera prej 466,567,443.76 € sa ka qenë e planifikuar. Buxheti i komunave për vitin 2017 është më i lartë për 22,779,621.53 € krahasuar me vitin 2016.

Rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm - Lidhur me opinionet e Auditorit, opinion pamodifikuar me theksim të çështjes i cili është dhënë në 22 komuna në vitin 2015 dhe në 33 komuna në vitin 2016, pastaj opinion i kualifikuar – me theksim të çështjes është dhënë në 9 komuna për vitin 2015 ndërsa për vitin 2016 këtë lloj opinion i kanë pranuar 4 komuna, opinion të kualifikuar në vitin 2015 kanë pranuar 2 komuna. Ndërsa, në vitin 2016 nuk ka pranuar këtë lloj opinion asnjë komunë. Opinion të kundërt në vitin 2015 kanë marrë 4 komuna, ndërsa në vitin 2016 nuk ka marrë asnjë komunë, opinion i pamodifikuar në vitin 2015 ka marrë 1 komunë, si dhe në vitin 2016 ka marrë vetëm 1 komunë.




# 1. Kuvendet e komunave

## 1.1. Funkzioni i Kuvendeve të Komunës


Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi i komunës konsiderohet si organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të legjislacionit për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës. Kompetencat dhe përgjegjësitë e kuvendit të komunës burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera, të cilat rregullojnë çështje të caktuara nga fusha e qeverisjes lokale në Kosovë. Në kuadër të përgjegjësive që ka kuvendi i komunës është edhe miratimi i akteve juridike nënligjore, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen dhe funksionimin efikas dhe efektiv të komunës. Përmes akteve të tilla, burojnë autorizimet përkatëse të ekzekutivit komunal për nxjerrjen e akteve administrative dhe zbatimin e tyre.

Për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë që i ka kuvendi i komunës, mbledhet në baza të rregullta periodike apo edhe në raste të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe urgjente të parapara sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë vitit 2017, kanë funksionuar kuvendet në 38 komuna të cilat kanë mbajtur mbledhjet sipas natyrës së punës, mbledhje këto të cilat kanë qenë të hapura për publikun e gjerë. Ligji për Vetëqeverisje Lokale thekson se kuvendi i komunës duhet të mbaj së paku 10 mbledhje në vit, 5 prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ndaj, gjatë vitit 2017 kuvendet e komunës në Republikën e Kosovës në 38 komuna kanë mbajtur 462 mbledhje, prej të tyre 323 mbledhje kanë qenë të rregullta, 52 mbledhje të jashtëzakonshme, 3 urgjente dhe 43 mbledhje solemne me rastin e zgjedhjeve lokale, kanë qenë edhe 38 mbledhje inauguruese. Këto të dhëna i kemi paraqitur në diagramin e mëposhtëm, si vijon:



Diagrami 1: Pasqyron numrin e mbledhjeve të kuvendeve të komunës të mbajtura gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017.

Kurse, sa i përket të dhënave mbi mbledhjet e mbajtura sipas komunave, më poshtë diagrami Nr. 2 ofron shpjegime për secilën komunë veç e veç, si vijon:



Diagrami 2: Pasqyron mbledhjet e mbajtura në 38 komuna sipas llojit dhe specifikeve tjera.

Nga ky diagram mund të shohim se pjesa më e madhe e komunave kanë përmbushur obligimet ligjore konform nenit 43.2 sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale<sup>1</sup>, përveç komunave: Fushë Kosovë, Prishtinë, Podujevë, Skenderaj, Mamushë dhe Hani i Elezit, të cilat kanë mbajtur më pak se 10 mbledhje me arsyetimin se ka qenë vit zgjedhor viti 2017.

Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqeve zyrtare të komunës, shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik. Nga kjo rrjedh që komunat janë kujdesur që ngjarjet e tyre t’i zhvillojnë në mënyrë transparente, duke publikuar në faqet zyrtare elektronike aktivitetet e kryera nga kuvendet e komunave, si dhe ekzekutivi i komunës. Përveç komunës së Junikut, Mamushës dhe Dragashit, të cilat në disa raste kanë pasur probleme teknike dhe nuk ka pasur mundësi për dërgimin e materialeve me kohë, kurse komunat: Partesh, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq në disa raste nuk kanë dërguar materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale. Ndërsa, si tema të rëndësishme të cilat kanë dominuar gjatë vitit 2017 në kuvendet e komunës kanë qenë temat rreth: miratimit të planeve të punës së kuvendeve të komunave, rishikimi i buxhetit, shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore komunale, planet e ndryshme rregulluese urbane, dhënia e pronave të paluajtshme të komunave në shfrytëzim, etj.

## 1.2. Konstituimi i Kuvendeve të Komunave

Në përputhje me vendimin e nxjerrë nga Presidenti i Republikës së Kosovës për shpalljen e zgjedhjeve lokale në vitin 2017, më datë 22 tetor 2017 janë mbajtur zgjedhjet lokale në të gjitha komunat. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas certifikimit të rezultateve zgjedhore, nga Komisioni Qendror Zgjedhor, në vazhdimësi ka punuar me strukturat e zgjedhura për implementimin e rezultateve zgjedhore dhe konstituimin e organeve të reja të komunave. MAPL ka bërë monitorimin lidhur me respektimin e proceduarave ligjore për inaugurimin e organeve të komunave, duke filluar nga thirrja e mbledhjeve inauguruese, dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe Kryetarët e Komunave, si dhe zgjedhja e trupave ndihmese të Kuvendit dhe Kryetarit në përputhje me obligimet e përcaktuara nga legjislati për vetëqeverisje lokale. Monitorimi i këtyre mbledhjeve është bërë përmes sistemit të

<sup>1</sup> Ligji Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

teleprezencës, përveç komunave: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok të cilat janë monitoruar me pjesëmarrje fizike të zyrtarëve të monitorimit.


Mbledhjet inauguruese janë mbajtur në të gjitha komunat, me ftesë nga kryetarët e zgjedhur. Në të gjitha komunat kanë dhënë betimin anëtarët e kuvendeve dhe kryetarët e komunave, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 35.4 dhe neni 57.1. Përveç dhënies së betimit nga anëtarët e kuvendeve dhe kryetarët e komunave, kuvendet e 17 komunave në dhjetor të vitit 2017, (Junik, Deçan, Dragash, Obiliq, Gillogoc, Gjakovë, Skenderaj, Vushtrri, Ferizaj, Fushë Kosovë, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Hani i Elezit, Shtime, Zubin Potok, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq) kanë zgjedhur edhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 41, ndërsa komunat tjera kryesuesin e kuvendit të komunës e kanë zgjedhur në fillim të vitit 2018.

### 1.3. Komitetet e Përhershme, Komitetet Konsultative dhe Komitetet Tjera

#### 1.3.1. Komitetet e Përhershme

Bazuar në legjislacionin për vetëqeverisje lokale, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e përhershme (obligueshme) për të mbështetur punën e tyre, përkatësisht Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Me qëllim të mbështetjes së organeve të komunës (kuvendit dhe ekzekutivit) në ushtrimin e kompetencave sektoriale, Kuvendi i Komunës mund të themelojë edhe komitete të tjera profesionale. Këto komitete kryesisht janë themeluar për sektorët specifik si në: arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik, shërbime publike etj. Veç kësaj, Kuvendi i Komunës ka përgjegjësi të themelojë edhe komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Sa u përket funksionimit të tyre, Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komiteti për Komunitete kanë qenë funksionale në të gjitha komunat. Më poshtë është paraqitur diagrami krahasues me numrin e mbledhjeve të komiteteve obligative:



Diagrami 3: Pasqyron numrin e mbledhjeve të Komiteteve për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve për Komunitete.

Pra, mund të vërehet se Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 325 takime, kurse Komiteti për Komunitete ka mbajtur 258 takime.

### 1.3.2. Komitetet Konsultative

Qeverisja lokale ka mekanizma të zhvilluara, të cilat ndikojnë në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, ndër to janë edhe Komitetet Konsultative. Formimi dhe mënyra e funksionimit të këtyre komiteteve është rregulluar me ligj dhe akte nënligjore. Duke parë qëllimin e ligjvënësimit për themelimin e këtyre mekanizmave, komunat edhe më tepër duhet t'iu japin hapësirë veprimi. Aktualisht, në 7 komuna të Kosovës janë funksionale këto komitete. Fokusi kryesor i këtyre Komiteteve ka qenë më shumë në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimit, kulturës, rinisë, sportit dhe shërbimeve publike, të cilat i kemi paraqitur si në tabelën e mëposhtme, si vijon:

Komitetet konsultative	Planifikim Hapësinor	Arsim	Zhvillim Ekonomik	Urbanizëm	Shëndetësi, Mirëqenie social	Shërbime Publike	Persona me aftësi të kufizuara	Çështje emergjente	Bujqësi, Zhvillim Rural, Mbrojtje të mjedisit	Kulturë, Rini, Sport	Administratë	Mbrojtje të mjedisit	Të drejta të njeriut, barazi gjinore	
Kamenicë		1	1			1		1		1				
Hani i Elezit			1					1		1				
Ferizaj			1	1						1	1			
Mitrovicë Jugore	1				1	1	1			1				
Gjilan	1													
Glllogoc		1	1		1									1
Vushtrri	1	1		1		1				1				
Gjithsej	3	3	4	2	2	3	1	2	0	5	1		1	Totale 27


Tabela 1: Pasqyron numrin e Komiteteve Konsultative në Komuna.

Siç mund të vërehet nga tabela e mësipërme, në 7 komuna janë themeluar gjithsej 27 komitete konsultative, në fushën e planifikimit hapësinor kanë themeluar komitetet konsultative komunat si vijon: Mitrovicë Jugore, Gjilan dhe Vushtrri, në fushën e arsimit komunat: Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj dhe Glllogoc, në fushën zhvillimit ekonomik: Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj dhe Glllogoc, në fushën e Urbanizmit komuna: Ferizaj dhe Vushtrri, në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale komuna: Mitrovicë jugore dhe Glllogoc, në fushën e shërbimeve publike komuna: Kamenicë, Mitrovicë jugore dhe Vushtrri, në fushën personat me aftësi të kufizuara komuna: Mitrovicë jugore, në fushën çështjet emergjente komuna: Kamenicë dhe Hani i Elezit, në fushën e kulturës rini dhe sport komuna: Kamenicë, Hani i Elezit dhe Ferizaj, Mitrovicë jugore, në fushën e administratës komuna e Ferizajt dhe në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore komuna: Glllogocit. Kurse, komunat tjera ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë.

### 1.3.3. Komitetet Tjera

Komitetet tjera po ashtu janë të rëndësishme për zhvillimin e qeverisjes lokale, ato njëherit konsiderohen edhe si subvencion i organeve të komunës me qëllim që organet në fjalë t'i ushtrojnë kompetencat e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si: arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Gjatë vitit 2017 janë themeluar këto Komitete të tjera në komuna, si vijon:

- Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, është themeluar në 9 komuna: Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Glllogoc, Prishtinë, Malishevë, Skenderaj dhe Podujevë.
- Komiteti për Arsim, Kulturë dhe Sport, është themeluar në 11 komuna: Deçan, Prizren, Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Glllogoc, Prishtinë, Malishevë, Skenderaj dhe Podujevë;
- Komiteti për Planifikim Hapësinor, është themeluar në 5 komuna: Prizren, Gjilan, Prishtinë, Malishevë dhe Podujevë;
- Komiteti për Bujqësi, është themeluar në 1 komunë: Fushë Kosovë;
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik, është themeluar në 8 komuna: Fushë Kosovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Ferizaj, Glllogoc, Prishtinë, Skenderaj dhe Podujevë;
- Komiteti për Urbanizëm, është themeluar në 5 komuna: Deçan, Prizren, Fushë Kosovë, Mitrovicë Jugore dhe Ferizaj;
- Komiteti për Shërbime Publike, është themeluar në 7 komuna: Prizren, Fushë Kosovë, Gjilan, Kaçanik, Mitrovicë Jugore, Junik dhe Prishtinë;
- Komiteti për Pronë, është themeluar në 1 komunë: komuna e Gjilanit;
- Komiteti për Persona me Nevoja të Veçanta, është themeluar në 2 komuna: Fushë Kosovë dhe në komunën e Ferizajt;
- Komiteti për Kategoritë e dala nga lufta, është themeluar në 1 komunë: komuna e Ferizajt;
- Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitar, është themeluar në 1 komunë: komuna e Gjilanit;
- Komiteti për Barazi Gjinore, është themeluar në 4 komuna: Prizren, Gjilan, Mitrovicë Jugore dhe Glllogoc.




Diagrami 4: Pasqyron numrin dhe llojet e Komiteteve tjera të themeluara nga Kuvendet e Komunës – periudha janar – dhjetor, 2017.

Mund të vërehet nga ky diagram se komunat gjatë periudhës një vjeçare kanë themeluar 55 Komitete të tjera, nga të cilët prijnë Komitetet për shëndetësi, arsim dhe në fushën e urbanizmit. Megjithatë, në disa komuna është vërejtur se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme.

#### 1.4. Raportimi i Kryetarit të Komunës

Sistemi i qeverisjes lokale është një njësi e gjerë e cila përfshinë edhe bashkëpunimin në mes të ekzekutivit të komunës dhe kuvendit me qëllim të realizimit të politikave publike në dobi të qytetarëve. Për këtë qëllim, mbikëqyrja dhe raportimi përbëjnë një proces mjaft të rëndësishëm të qeverisjes lokale, përmes të cilit mundësohet përcjellja sistematike e ngjarjeve dhe aktiviteteve brenda komunës. Kuvendi i komunës është organ i autorizuar me ligj për kontrollin e kryetarit të komunës. Nga ky aspekt, raportimi është një mjet kontrolli, të cilin e zbaton kuvendi i komunës ndaj kryetarit për të siguruar zbatimin e politikave të planifikuara. Raportimi shikohet edhe si formë e bashkëpunimit që mundëson funksionimin komplementar të dy organeve, kuvendit dhe kryetarit. Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në intervale të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Të drejtën për të kërkuar raportim nga ekzekutivi e kanë ad hoc edhe anëtarët e kuvendeve të komunave, çdo herë kur e vlerësojnë të nevojshme. Për këtë arsye prezenca e kryetarëve të komunave dhe drejtorëve të drejtorive është e domosdoshme gjatë zhvillimit të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Të dhënat e mbledhura gjatë procesit të monitorimit të komunave lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të raportuar para kuvendeve të komunave, sidomos për situatën ekonomiko – financiare dhe zbatimin e planeve investuese, obligim ky i cili duhet të përmbushet së paku njëherë në gjashtë muaj apo çdo herë kur kërkohet një gjë e tilla nga ana e kuvendit të komunës<sup>2</sup>. Prandaj, gjatë periudhës një vjeçare numri i raportimeve të kryetarit të komunës para kuvendit në 38 komunat e Republikës së Kosovës, ka qenë si vijon:




Diagrami 5: Pasqyron numrin raportimeve të Kryetarëve të Komunave lidhur me situatën ekonomiko-financiare.

<sup>2</sup> Ligji Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 58, pika j.

Bazuar në diagramin Nr. 5 mund të vërehet se vetëm kryetari i komunës së Klllokotit nuk ka raportuar asnjëherë gjatë vitit 2017, ndërsa kryetarët e komunave Glllogoc, Skenderaj, Klinë, Lipjan, Obiliq, Suharekë, Zveçan dhe Zubin Potok kanë raportuar vetëm nga një herë brenda periudhës raportuese duke mos e përmbushur obligimin ligjor për raportim në kuvendin e komunës ashtu siç është e përcaktuar në nenin 58 pika j) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Kurse, kryetarët e komunave të cilat kanë raportuar dy e më tepër për situatën ekonomiko-financiare janë si vijon: Kaçanik, Istog, Pejë, Shtime, Ferizaj, Shtërpçë, Mitrovicë Jugore dhe Mitrovicë Veriore.

### 1.5. Takimet Publike me Qytetarë

Në nivelin e pushtetit lokal, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve gjatë zhvillimit të procesit të politikbërjes është mjaft e shprehur dhe është zgjeruar përmes mekanizmave të ndryshëm të paraparë me ligj. Instrumentet e pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave, janë kritere të demokracisë së drejtpërdrejtë që plotësojnë demokracinë moderne e cila kryesisht identifikohet me qeverisjen nga të zgjedhurit. Duke marrë parasysh nevojën e komunikimit të vazhdueshëm me qytetarë për marrjen e pikëpamjeve të tyre gjatë procesit të politikbërjes dhe qeverisjes, komunat kanë disa mundësi përmes normave të detyrueshme ligjore, që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet e drejtpërdrejta, komitetet konsultative, informimin publik, qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe metoda të tjera shitesë që i kontribuojnë transparencës dhe avancimit të qeverisjes lokale. Të dhënat e mbledhura për rezultatet e komunave në përfshirjen e qytetarëve përmes takimeve publike japin një informacion për peshën e demokracisë lokale në komuna. Më poshtë janë prezantuar të dhënat për takimet publike në komuna të thirrura sipas nenit 68.1 të LVL-së, si vijon:




Diagrami 6: Pasqyron numrin raportimeve të Kryetarëve të Komunave lidhur me situatën ekonomiko-financiare.

Ky diagram pasqyron faktin se shumica e komunave kanë përmbushur këtë obligim ligjor, me përjashtim të Komunës së Klllokotit e cila nuk ka mbajtur asnjë takim publik, ndërsa komuna e Novobërdës, Kaçanikut, Glllogocit, Skenderajt, Gjakovës, Klinës, Istogut, Pejës, Prishtinës, Ferizajt, Shtërpçës, Mitrovicës Jugore, Fushë Kosovës, Suharekës, Leposaviqit, Mitrovicë Veriore, dhe Zveçanit të cilat kanë mbajtur nga një takim publik me qytetarë brenda vitit 2017. Veç këtyre takimeve, komunat kanë mbajtur takime të tjera shitesë me qytetarë, në vendbanime të caktuara dhe për çështje të ndryshme duke përfshirë: diskutimet buxhetore, planet hapësinore në nivel lokal, propozim-aktet e obligueshme për diskutim publik, si dhe takime të tjera të vlerësuara nga komunat. Po ashtu, komunat kanë publikuar aktet e tyre në ueb faqet e komunës, të cilat i kemi paraqitur, si vijon:

## 1.6. Publikimi i Akteve në faqet elektronike të Komunave

Një nga përgjegjësitë e komunave është funksionalizimi i faqeve të komunave dhe publikimi i akteve. Kjo përgjegjësi lidhet ngushtë me komponentën e transparencës, llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë. Komunitetet ushtrojnë kompetenca të pavarura në kuadër të juridiksionit të tyre dhe kanë një sërë aktivitete të ndryshme, të cilat duhet t'i njoftojnë qytetarët. Për këtë qëllim, publikimi i informatave relevante në faqet e komunës është një obligim ligjor, obligim ky i cili ndikon që komuna të jetë më transparente në raport me qytetarët. Detyra për publikimin e akteve komunale është çështje e normuar me Rregulloren Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Sipas kësaj Rregulloreje, publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe (janar – dhjetor, 2017), nga 1405 akte gjithsej sa kanë miratuar kuvendet e komunave, 1261 janë të publikuara në ueb-faqet zyrtare të komunave. Të dhënat e komunave lidhur me publikimin e akteve në ueb faqen zyrtare të komunës janë si vijon:



Diagrami 7: Pasqyron numrin e publikimit të akteve komunale në ueb faqet e komunave.

Vërehet se në komunitetet Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan, Gjakovë, Klinë, Mamushë Hani i Elezit dhe Ferizajt nuk janë funksionale ueb faqet zyrtare të komunës për këtë edhe nuk i kanë aktet e publikuara. Disa komuna të tjera, kanë zgjedhur publikimin e akteve në momentin e nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit si komuna Glllogocit, ndërsa disa komuna si komuna e Prishtinës nuk publikojnë aktet deri në vlerësimin e ligjshmërisë nga MAPL apo ministrit e linjës. Kurse, komunitetet të cilat kanë respektuar publikimin e akteve në gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë: Komuna e Prishtinës, Vushtrrisë, Rahovecit ndërsa komunitetet të cilat i kanë publikuar aktet vetëm njëherë nga gjuhet zyrtare të Republikës së Kosovës janë Komuna e Mitrovicës Jugore, Skenderajt, Kaçanikut, Fushë Kosovës, Prizrenit, Lipjanit, Pejës, Istogut, Obiliqit, Suharekës, Dragashit, Podujevës, Kamenicës, Gjilanit, Rahovecit, Deçanit, Junikut, Fushë-Kosovë, Shtimes, Malishevës, Vitisë, Gjilanit, Glllogocit, Suharekës, Parteshi, Graçanicës, Ranillugut, Kllokotit dhe Shtërpcës. E veçanta e disa komunave është se publikimin e akteve e bëjnë edhe në gjuhë zyrtare tjera si komuna e Prizrenit në gjuhën turke dhe komuna e Prishtinës në gjuhë angleze në mënyrë që opinioni të jetë sa më i informuar.



## 1.7. Aktet Komunale


Vendimmarrja si proces është pjesë mjaft e rëndësishme e nivelit lokal të qeverisjes. Përmes këtij procesi qytetarët përfitojnë si për nga aspekti i përmirësimit të kualitetit të jetës po ashtu edhe përmes shërbimeve publike të cilat ofrohen nga ana e pushtetit lokal. Ndaj, kuvendet e komunave kanë mandatin për të miratuar dhe zbatuar vendime të cilat përfaqësojnë interesat e përgjithshme të qytetarëve dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi. Kuvendet konform përgjegjësi që kanë, miratojnë Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, vendime, rregullore dhe aktet tjera të përgjithshme, miratojnë buxhetet e komunave, themelojnë komitetet e përhershme, komitete konsultative dhe komitete të tjera, si dhe akte tjera të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Kurse, kriteret dhe procedurat e vendimmarrjes janë mjaft të rëndësishme dhe kërkohen të jenë në pajtim me parimet kryesore siç është: kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, efikasiteti dhe efektiviteti, mosdiskriminimi, transparenca, interesit publik, si dhe parimeve të tjera të cilat sigurojnë një qeverisje të mirë dhe efektive. Në periudhën janar – dhjetor, 2017 komunat e Republikës së Kosovës, kanë miratuar 77 rregullore dhe 1328 vendime. Akte e miratuara janë të ndryshme, përfshirë: ato të natyrës financiare (miratimi i buxhetit, miratimi i kornizës afatmesme buxhetore, kornizën afatmesme të shpenzimeve, akte për bartjen e mjeteve financiare nga viti fiskal paraprak në vitin 2017), mjedisore, ekonomike, arsimit, sociale, urbanistike etj.

### Numri i akteve të miratuara 2017

**77** Rregullore

**1328** Vendime

Diagrami 8: Pasqyron numrin e akteve të miratuara në periudhën janar – dhjetor, 2017.




Ky diagram pasqyron të dhënat numerike të akteve të miratuara nga kuvendet e komunave të Kosovës, ku numrin më të madh të rregulloreve e ka miratuar Kuvendi i Komunës së Graçanicës 7 rregullore i pasuar nga komuna e Klinës dhe Istogut me nga 5 rregullore, derisa numrin më të madh të vendimeve Kuvendi i Komunës së Ferizajt gjithsej 105 vendime, si dhe kuvendi i komunës se Graçanicës me 102 vendime.

## 1.8. Shqyrtimi i Ligjshmërisë së Akteve Komunale

MAPL përveç monitorimit të komunave është edhe autoritet mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe me këtë është shfuqizuar Vendimi Nr. 2/119 e qeverisë i datës 7 Prill 2010. Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor. MAPL-ja ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së 556 akteve, ndërsa në ministri të linjës janë dërguar 846 akte të komunave për vlerësim të ligjshmërisë.


## 1.9. Veprimet për Harmonizim të Akteve të Kundërligjshme nga Komunitat

Gjatë monitorimit të komunave për vitin 2017, si dhe vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale nga MAPL janë konfirmuar të ligjshme 556 akte, ndërsa janë konstatuar 23 kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë, për të cilat MAPL ka dërguar shkresat për rishqyrtim dhe harmonizim të tyre nga komunitat në pajtim me legjislacionin në fuqi. Pas kësaj, komunitat kanë bërë harmonizimin e 7 akteve konform kërkesës për harmonizim, 16 kërkesa për rishqyrtim të akteve ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës. Natyra e kërkesave për të cilat MAPL ka kërkuar nga komunitat ti rishqyrtojnë dhe ti harmonizojnë vendimet e kuvendit është: dhënia e pronës komunale në shfrytëzim, emërimi i anëtarëve të KPF-së, miratimi i statutit të komunës, pastaj vendimet për emërtim të rrugëve si dhe shkelje procedurale në miratimin e vendimeve për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, vendimet për hartimin e planeve zhvillimore komunale, hartave zonale komunale, miratimi i planeve për menaxhimin e mbeturinave, vendimet për shpronësim, vendimet për falje të borxheve, etj. Në vijim janë të paraqitura përmes tabelave kërkesat për rishqyrtim të akteve për secilën komunë të konstatuara nga MAPL dhe ministritë e linjës:




Diagrami 9: Pasqyron numrin e akteve të kundërligjshme dhe të harmonizuara sipas komunave.

Kurse, sa i përket kërkesave për rishqyrtim për aktet të cilat nuk janë shqyrtuar konform kërkesave të MAPL-së, kemi këto të dhëna, si vijon:



Diagrami 10: Pasqyron numrin e akteve të kundërligjshme dhe të paharmonizuara sipas komunave.



Diagrami 11: Numri i përgjithshëm i shkeljeve të konstatuara gjatë vitit 2017<sup>3</sup>.


Shkeljet ligjore të komunave të identifikuar nga MAPL dhe për të cilat ka adresuar kërkesat për rishqyrtim, kryesisht kanë të bëjnë me: procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim (kryesisht për rastet e ndarjes së pronës për ndërtim individual të banimit), këmbimin e pronës komunale, ndërtimit të objekteve fetare, procedurave për bashkëpunim ndërkomunal, emërimin e anëtarëve në komitetet e obligueshme, kushtëzimin e qytetarëve me kryerjen e obligimeve për shërbimet komunale, etj.

<sup>3</sup> Për më shumë detaje në shtojcën 1 dhe 2 kemi paraqitur tabelat e shkeljeve ligjore në komuna si dhe veprimet e ndërmarra nga komunat lidhur me kërkesat për rishqyrtim.

## 1.10. Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBS). Themelimi i KKSBS-së bazën ligjore e ka në Ligjin për Policinë, ndërsa procedurat e themelimit, përbërja, mënyra e funksionimit dhe obligime të tjera janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Në vitin 2014 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka miratuar edhe Manualin për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përmes të cilit dokument është synuar të rrisim vetëdijen e zyrtareve komunal për ndikimin e instrumenteve të kontrollit formal dhe joformal shoqëror për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për qytetarët. Këshilli komunal për siguri në bashkësi është themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.

Me udhëzimin administrativ për KKSBS, ndër të tjera është rregulluar edhe numri minimal prej gjashtë takimeve në vit, tri prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë. Për numrin e takimeve, është paraqitur diagrami në vijim: Për nga numri i takimeve, më aktiv ka qenë Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Hanit të Elezit me gjithsej 12 takime të mbajtura, 6 takime ka mbajtur KKSBS në komunën e Ferizajt, Kaçanikut, Mitrovicës Jugore, Gjilanit, dhe Shtërpçës, nga 5 takime KKSBS ka mbajtur në Komunën e Dragashit, Obiliqit, Vushtrrisë, Klinës, Novobërdës dhe Suharekës, nga 4 takime ky këshill ka mbajtur në Komunën e: Rahovecit, Vitisë, Podujevës, Pejës, Istogut, Lipjanit, nga 3 takime ka mbajtur në komunën e Malishevës, Deçanit, nga dy takime ka mbajtur në komunat: Prizren, Junik, Ranillug, Partesh, Prishtinë, Skenderaj, Glllogoc dhe Gjakovë, si dhe 1 takim ka mbajtur në Komunën e Mamushës. Ndërsa, Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi nuk ka mbajtur asnjë takim në Komunën e Shtimes, Fushë Kosovës, Kamenicë, Klllokotit, dhe Graçanicës.



Diagrami 12: Numri i takimeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Lidhur me temat dhe problemet të cilat janë trajtuar gjatë këtyre takimeve, kryesisht kanë dominuar temat, si vijon:

Temat e mbuluara	Rezultatet
Siguria në shkolla	Vendosja e kamerave në shkolla, shtimi i sigurisë, vendosja e rrethojave etj.
Trashëgimia kulturore	Masat e ndërmarra për ruajtjen e saj
Siguria në komunikacion	Patrullimi i policisë, kontrolli i automjeteve

Paraqitja e Rasteve Emergjente	Hartimi i Planit Operativ për reagime Emergjente
Mbarëvajtja e Zgjedhjeve	Mbajtja e Konferencave
Përdorimi i narkotikëve nga të rinjtë	Bashkëpunimi me qytetarë Prioritet më i madh por të vetëdijesuar të rinjtë nga dukuritë negative
Përgatitja e zgjedhjeve lokale	Mbarëvajtja e zgjedhjeve
Mbeturinat në rrugë	Vendosja e shportave nëpër rrugë, angazhim më i madh i kompanisë së kontraktuar, përmbushja e detyrimeve të pagesave për mbeturina nga qytetarët.
Mungesa e trotuareve nënkalimeve dhe shenjave sinjalizuese	Ndërtimi i trotuareve në afërsi të shkollave, Sigurimi dhe organizimi i transportit nga fshatrat deri në qytet dhe anasjelltas
Gjendja e furnizimit me ujë gjatë sezonit veror	Prioriteti i komunës për ndërtimin e trotuareve; ndihmesë nga policia në vendosjen e shenjave sinjalizuese, Shtim i patrullimit në këmbë të policisë nëpër qytet.

Tabela 2: Pasqyron temat e takimeve të mbuluara të Këshillit për Siguri në Bashkësi në komuna dhe rezultatet e temave.

Sa u përket iniciativave për realizimin e projekteve për siguri në bashkësi gjatë vitit 2017, janë të planifikuara këto projekte të cilat kanë dalë si propozim takimet e KKSb-së:

- Sensibilizimi dhe inicimi i aktiviteteve për parandalimin e qitjes me armë në dasma, ahengje dhe manifestime publike;
- Kastrimi i qenve endacak;
- Vendosja e kamerave në qytet;
- Ndriçimi publik;
- Hartimi i Planit operativ në koordinim me Policinë e Kosovës sa i përket Zjarrvënies.
- Iniciativa për vendosjen e shenjave të komunikacionit;
- Rregullimi dhe vënia në funksion e sistemit të alarmit publik të banorëve të komunës;
- Kontrollimi i zonave të dyshimta për mjete shpërthyes;
- Asfaltimi i rrugëve;
- Vendosja e kanalizimeve;
- Pastrimi i mbeturinave;
- Adaptimi i kushteve për të kthyerit;
- Kastrimi i qenve endacak.

Kurse, sa i përket sfidave me të cilat ballafaqohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, disa nga to janë:

- Gjetja e fondeve për realizimin e projekteve të propozuara nga KKSb-të;
- Pagesa e anëtarëve të KKSb-së;
- Ndotja e Ambientit;
- Vendosja e nënkalimeve në rrugët kryesore sidomos afër shkollave;
- Siguria në trafik.

## 2. Agjenda Evropiane



Republika e Kosovës me rastin e nënshkrimit të MSA me Bashkimin Evropian ka hyrë në një kapitull të ri. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e nënshkruar nga Republika e Kosovës me BE-në e cila ka hyrë në fuqi me 1 prill të vitit 2016, si dhe Programi Kombëtar për zbatimin e MSA-së, i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 10 mars të vitit 2016, obligon institucionet publike që t'i kryejnë detyrat konform përgjegjësi që kanë. Për këtë qëllim, edhe MAPL konform përgjegjësi dhe obligimeve që ka sidomos në raport me komuna, gjatë vitit 2017 ka ndërmarrë një sërë veprimesh për adresimin dhe zbatimin e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane. Kjo agjendë është fokusuar në tri kryesore: a)

në kriteret politike, b) kriteret ekonomik, dhe c) standardet evropiane, me qëllim që komunat e Republikës së Kosovës të kenë më të lehtë zbatimin e kriterëve në fjalë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2017 janë përgatitur matricat individuale të komunave nga obligimet e agjendës evropiane, duke përfshirë këtu: Dialogun për Procesin e Stabilizim Asociimit, PKZMSA-në dhe dokumente tjera relevante, mbi bazën e të cilave janë ofruar të dhëna në këtë kapitull.

Bazuar nga të dhënat e ofruar nga komunat, gjatë vitit 2017 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 67% të aktiviteteve në fushën e kriterëve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kriterëve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 75% të kriterëve dhe në fushën e standardev evropiane, ato kanë realizuar 61% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2017 është 67%.


### 2.1. Kriteret politike

#### 2.1.1. Administrata publike

Trajnimet për zyrtarët komunal – Nga gjithsej 38<sup>4</sup> komuna, 30 prej tyre e kanë hartuar Programin e Trajnimeve, kurse 7 komuna nuk kanë organizuar asnjë trajnim për zyrtarët komunal (komunat: Kamenicë, Lepsaviq, Shtërpçë, Mamushë, Ranillugë, Partesh dhe Mitrovicë Veriore), që nënkupton se 81% e komunave posedojnë një program të tillë kundrejt 19% të komunave që nuk e posedojnë ose ende nuk e kanë hartuar. Lidhur me trajnimet të cilat janë zhvilluar në komuna, sipas të dhënave në 30 komuna janë mbajtur 619 trajnime për zyrtarët komunal, mesatarisht 21 trajnime për komunë. Komunat të cilat kanë pasur trajnime, janë fokusuar në temat, si: *Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane, trajnim TLP (Transformational Leadership Programm) për qeverisje publike, Hartimi i projekteve për fondet e IPA-së, Menaxhimi i pronës komunale, Ridizajnimi i uebfaqeve të komunave, Parimet dhe objektivat e administratës moderne sipas kriterëve të Bashkimit Evropian, Efikasiteti në administratën lokale, Katalogu i vendeve të punës, komunikimi me mediat; Buxhetimi, Gjendja Civile, Zhvillimi Ekonomik Lokal, Menaxhimi me Dokumente Arkivore, Hulumtimi cilësore*

<sup>4</sup> Komuna e Zubin Potokut nuk ka raportuar për periudhën janar – dhjetor, 2017.

lidhur me normat sociale dhe Faktorët që ndikojnë dhunën në familje, etj. Në vijim do t'i pasqyrojmë trajnimet dhe numrin e zyrtarëve të trajnuar, si vijon:




Diagrami 13: Numri i zyrtarëve komunal të cilët kanë marrë pjesë në trajnime sipas komuna.

Mund të shohim se gjatë vitit 2017 në 30 komuna janë trajnuar gjithsejtë 1037 zyrtar/e komunal. Ndërsa, 7 komuna: *Ranillug, Dragash, Mamushë, Prishtinë, Leposaviq, Hani Elezit dhe Partesh* gjatë kësaj periudhe nuk kanë trajnuar asnjë zyrtarë komunal për ndonjë fushë përkatëse.

Katalogu i vendeve të punës - Në kuadër të progresit të administratës publike të nivelit lokal, janë 36 komuna që kanë Përgatitur Katalogun e Vendeve të punës në Shërbimin Civil në komunë. Ndërsa 1 komunë (*Leposaviq*) nuk e ka përgatitur ende këtë katalog.

Transparenca dhe qasja në dokumentet zyrtare – Gjatë periudhës një vjeçare, komunat e Republikës së Kosovës kanë bërë një punë goxha të madhe në fushën e transparencës, ku nga 38 komuna, 34 komuna kanë pasur 865 kërkesa, 3 komuna nuk kanë pasur kërkesa fare dhe 1 (një) komunë nuk ka raportuar fare.



Diagrami 14: Numri i kërkesave në komuna për qasje në dokumente publike.

Siç mund të shihet nga diagrami në fjalë, prej 38 komunave, 34 komuna kanë pasur 865 kërkesa për qasje në dokumente publike, ndërsa në 3 komuna: Mamushë, Novobërdë dhe Mitrovica Veriore), kurse komuna e Zubin Potok-ut nuk ka raportuar fare nuk kanë pasur ndonjë kërkesë. Ky diagram po ashtu tregon se komuna e Prishtinës është liderë sa i përket kërkesave për qasje në dokumente publike, duke u pasuar nga komuna e Klinës dhe ajo e Lipjanit.


Përdorimi i gjuhëve zyrtare – Sa i përket respektimit të gjuhëve zyrtare në komuna, sipas të dhënave 26 komuna kanë publikuar në ueb faqen e tyre aktet e nxjerra nga organet e komunës në gjuhët zyrtare, gjuhë shqipe dhe gjuhë serbe, në 3 komuna: Vushtrri, Malishevë dhe Hani Elezit, aktet janë publikuar pjesërisht. Ndërsa, 3 komuna të tjera, si: Mamushë, Ranillug dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë publikuar akte në gjuhët zyrtare, përderisa 5 komuna: Ferizaj, Obiliq, Gjakovë, Klinë dhe Zveçan kanë pasur probleme teknike me faqet zyrtare të tyre me ç'rast edhe nuk kanë mundur që t'i publikojnë aktet e tilla në gjuhët zyrtare sipas legjisllacionit në fuqi.

Konsultimet dhe takimet publike – Gjatë periudhës një vjeçare komunat kanë shënuar edhe progres në raport me konsultimet dhe takimet publike. Një gjë e tillë vërehet më shumë tek disa komuna se sa tek disa të tjera. Mirëpo, në përgjithësi mund të konsiderohet si progres, të dhënat nga MAPL tregojnë se gjatë kësaj periudhe në 31 komuna janë mbajtur 187 konsultime publike për shqyrtimin e draft akteve komunale. Ndërsa, 6 komuna: Mamushë, Skenderaj, Junik, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Kamenicë nuk kanë mbajtur asnjë konsultim publik. Përveç kësaj, shohim se 32 komuna kanë organizuar gjithsejtë 482 takime me qytetarët me qëllim të informimit, koordinimit dhe bashkëpunimit në vendimmarrje e cila konsiderohet si pjesë thelbësore e fushës së transparencës. Megjithëse, komunat si: Kamenicë, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Shtërpcë dhe Mamushë nuk kanë pasur takime të tilla. Ndërsa, komuna e Lipjanit është komuna e cila ka mbajtur më së shumti konsultime publike me qytetarët gjatë kësaj periudhe, ndërsa komuna e Gjakovës është komuna që ka numrin më të madh të takimeve publike gjatë kësaj periudhe.

Qendrat për shërbim të qytetarëve – Në kuadër të kësaj fushe, të dhënat nga MAPL tregojnë se Qendrat për shërbim të qytetarëve janë themeluar në komunën e Mitrovicës Veriore, ndërsa në 2 komuna: Leposaviq, Zveçan nuk janë themeluar ende. Gjithashtu, procesi i funksionalizimit të Administratës ka filluar në 3 komuna (Mitrovicës Veriore, Zveçan dhe Leposaviq).

Përfshirja e komuniteteve jo shumicë në institucionet lokale – Pjesa më e madhe e komunave të Republikës së Kosovës kanë ndërmarr veprimet e nevojshme në kuadër të juridiksionit të tyre për përfshirjen e minoriteteve në institucionet lokale. Ndaj, gjatë periudhës janar – dhjetor 2017, 23 komuna kanë ndërmarr veprime të tillë, kurse 6 komuna: Kllokot, Rahovec, Mitrovicë Veriore, Mamushë, Malishevë, Rahovec nuk kanë ndërmarr asnjë veprim të tillë. Kurse, 8 komuna: Junik, Glllogoc, Kaçanik, Hani Elezit, Ranillug, Zveçan dhe Parteshi, Dragash nuk kanë komunitet jo – shumicë. Më tej, të dhënat nga MAPL tregojnë se disa komuna gjatë vitit 2017 kanë punësuar edhe pjesëtarë nga komunitetet minoritare. Kështu, numri i të punësuarve nga radhët e pjesëtarëve të komuniteteve minoritare në administratën publike në 29 komuna është 1664, ndërsa 3 komuna: Gjilan, Leposaviq dhe Graçanicë nuk kanë ofruar të dhëna, si dhe 5 komuna të tjera, si: Glllogoc, Junik, Kaçanik, Hani i Elezit dhe Partesh nuk kanë komunitete fare. Më poshtë, diagrami pasqyron më detajisht këto të dhëna, si vijon:






Diagrami 15: Pasqyron numrin e të punësuarve nga radhët e komunitetit RAE sipas komunave.

### 2.1.2. Avokati i popullit

Gjatë periudhës raportuese, të dhënat nga MAPL pasqyrojnë se komunat i kanë kushtuar rëndësi edhe organizimit dhe funksionimit të zyrave të Avokatit të Popullit, përkatësisht qasjes së gjithë qytetarëve në këto zyra. Në 5 komuna: Pejë, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë dhe Prizren, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet lokale janë të qasshme për personat me aftësi të veçanta. Ndërsa, 1 komunë - komuna e Mitrovicës hapësirat e punës së Institucionit të Avokatit të popullit i ka të qasshme pjesërisht, si dhe në 3 komuna: Graçanicë, Mitrovicë Veriore dhe Gjakovë ende nuk janë arritur kushtet e domosdoshme për qasjen e kësaj kategorie.



Diagrami 16: Pasqyron numrin e kërkesave tek Avokati i popullit sipas komunave.


Pra, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, 6 komuna: Gjakovë, Istog, Prishtinë, Kaçanik, Viti dhe Partesh kanë pranuar 18 kërkesa/rekomandime nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ndërsa 31 komuna nuk kanë pranuar asnjë kërkesë apo rekomandim nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Lidhur me këto kërkesa, 6 komuna: Gjakovë, Istog, Prishtinë, Kaçanik, Viti dhe Partesh kanë kthyer 13 përgjigje pozitive Institucionit të Avokatit të Popullit, ndërsa 1 komunë (Istogu) ka kthyer 2 përgjigje negative. Gjithashtu, në 3 komuna të tjera, si: Gjakovë, Istog dhe Prishtinë janë 3 kërkesa/rekomandime në proces të shqyrtimit.

### 2.1.3. Shoqëria Civile

Bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile konsiderohet një prej shtyllave të demokracisë bashkëkohore, për këtë qëllim të dhënat tregojnë se komunat gjatë vitit 2017 kanë pasur bashkëpunime me organizatat e shoqërisë civile. Nga 38 komuna gjithsejtë sa janë në Kosovë, 26 komuna kanë ndarë shumën e mjeteve financiare në vlerë totale prej 1,930,311.16 €, ndërsa 11 komuna: Klinë, Leposaviq, Rahovec, Mitrovicë Veriore, Mamushë, Kamenicë, Kllokot, Hani Elezit, Partesh, Leposaviq dhe Zveçan, nuk kanë ndarë buxhet të veçantë për përkrahjen apo realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me OSHC-të lokale. Kurse, lidhur me numrin e projekteve të përkrahura financiarisht në 26 komuna është 632, si dhe 10 komuna: Mamushë, Shtërpçë, Klinë, Kamenicë, Kllokot, Hani Elezit, Prizren, Partesh, Mitrovica Veriore dhe Leposaviq nuk kanë pasur projekte të përkrahura.

#### 2.1.4. Lufta Kundër Korrupsionit

Deklarimi i pasurisë – Në këtë segment, numri i personave zyrtar që kanë deklaruar pasurinë në 33 komuna është 1490, ndërsa 4 komuna (Mamushë, Ranillug, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë ofruar informacione. Nga diagrami i mëposhtëm shohim se komuna e Prishtinës ka numrin më të madh të zyrtarëve që janë të obliguar dhe që deklarojnë pasurinë e tyre sipas ligjit në fuqi me gjithsejtë 76 zyrtar të lartë publik. Ndërsa komuna me më së paku zyrtar të lartë publik që janë të obliguar dhe që deklarojnë pasurinë është komuna e Kllokotit me gjithsejtë 23 zyrtar, si vijon:



Diagrami 17: Pasqyrimi i numrit të personave zyrtarë që deklarojnë pasurinë sipas komunave.

Nga diagrami i lartcekur mund të shohim se në 35 komuna nuk ka asnjë zyrtar që nuk e deklaron pasurinë, që me ligj është i detyruar të deklaroj, ndërsa në 2 komuna: Vushtrri dhe Fushë Kosovë janë 4 zyrtar.

Konflikti i interesit - Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, të dhënat në MAPL tregojnë se 35 komuna nuk kanë ndonjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit nga zyrtarët komunal apo anëtarët e Kuvendit të Komunës. Ndërsa në 2 Komuna: Gjakovë dhe Mitrovicë ka pasur 7 raste të deklarimit të konfliktit të interesit.

Punët e brendshme dhe lufta kundër krimit të organizuar - Në 34 komuna është funksionale Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe numri i zyrtarëve në 34 komuna është 106, ndërsa komuna Rahovec nuk ka ofruar të dhëna për numrin e zyrtarëve, si dhe në 2 komuna: Leposaviq dhe Zveçan: ende nuk janë funksionale këto zyra.

### 2.1.5. Planet lokale për Integritet

Planin Lokal për Integritet e kanë hartuar 15 komuna, ndërsa 22 komuna: Gjakovë, Shtime, Mamushë, Shtërpçë, Malishevë, Deçan, Suharekë, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Prizreni, Hani Elezit, Klllokot, Dragash, Skenderaj, Junik, Mitrovica Veriore, Prishtinë, Kamenicë, Leposaviq, Zveçan dhe Kaçanik, ende nuk e kanë hartuar këtë plan. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe 12 komuna kanë caktuar zyrtarin që raporton për zbatimin e Planit të Veprimit Komunal Kundër Korrupsionit. Kurse, 25 komuna: Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Ferizaj, Deçan, Klinë, Rahovec, Pejë, Gjakovë, Vushtrri, Obiliq, Prizren, Viti, Hani Elezit, Klllokot, Glllogoc, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Kaçanik, Mitrovicë, Leposaviq dhe Podujevë, nuk e kanë caktuar ende. Sa i përket raporteve, 3 komuna: Ranillug, Zveçan dhe Partesh, kanë të publikuar 4 raporte, ndërsa 34 komuna nuk kanë publikuar raportet mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet.

### 2.1.6. Veprimet Kundër Luftës së Terrorizmit

Çështja e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm është segment global i cili ka zgjuar alarm edhe tek institucionet publike. Përderisa niveli qendror ka hartuar politikat publike për masat ndaj këtij fenomeni global, në nivelin lokal mund të shohim se janë organizuar një sërë aktivitetesh për këtë qëllim. Lidhur me vetëdijesimin e qytetarëve kundër terrorizmit, 22 komuna kanë ndërmarrë veprime si në vijim: debate të përbashkëta me Bashkësinë Islame për vetëdijesimin e qytetarëve kundër terrorizmit, janë organizuar takime nëpër shkollë, takim me anëtarët e KKS-së ku temë diskutimi ka qenë terrorizmi. Ndërsa, 15 komuna: Rahovec, Gjilan, Gjakovë, Lipjan, Obiliq, Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Dragash, Junik, Mitrovica Veriore, Podujevë, Leposaviq, Zveçan dhe Fushë Kosovë, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim për këtë temë.

### 2.1.7. Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Promovimi i të drejtave të njeriut - Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, shumica e komunave mbajnë aktivitete të ndryshme në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, prej tyre 24 komuna kanë organizuar 143 aktivitete me temat, si: promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, të drejtat në trashëgimi, sensibilizimi dhe promovimi i ligjit të ri për Barazi Gjinore, fushata kundër diskriminimit, fushatat për të drejtat e fëmijëve, fushata kundër trafikimit me qenien njerëzore, regjistrimi i pronësisë në emër të dy bashkëshortëve, sensibilizimi i buxhetit, rritja e pjesëmarrjes së Grave në veri të Kosovës, Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve komunat Veriore etj, ndërsa 13 komuna: Rahovec, Deçan, Mamushë, Shtërpçë, Hani Elezit, Klllokot, Dragash, Junik, Skenderaj, Mitrovica Veriore, Podujevë, Leposaviq dhe Kaçanik nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.


Trajnimet për të drejtat e fëmijëve - Sa i përket trajnimeve të organizuar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në 21 komuna janë mbajtur 58 trajnime, ndërsa 16 komuna: Mamushë, Malishevë, Shtërpçë, Rahovec, Klinë, Gjakovë, Gjilan, Prishtinë, Prizren, Hani Elezit, Klllokot, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Kaçanik, Fushë Kosovë dhe Graçanicë nuk kanë organizuar ndonjë trajnim.

Rregulloret komunale për të drejtat e fëmijëve - Rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve e kanë hartuar 18 komuna, ndërsa 19 komuna: Deçan, Lipjan, Suharekë, Shtërpçë, Mamushë, Novobërdë, Rahovec, Ranillug, Gjilan, Prizreni, Klllokot, Dragash, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Prishtinë, Istog, Zveçan dhe Leposaviq nuk e kanë hartuar ende.

Baza e të dhënave për raportimin e dhunës mbi baza gjinore - Sa i përket rasteve të dhunës në baza gjinore, 23 komuna kanë pasur 485 raste, ndërsa 14 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Deçan, Pejë, Podujevë, Hani Elezit, Kllokot, Kaçanik, Leposaviq, Zveçan, Mitrovicë Veriore dhe Partesh nuk kanë pasur ndonjë rast të tillë. Në kuadër të përfshirjes dhe planifikimit buxhetor, për të ngritur kapacitetin e koordinitorit apo zyrtarit komunal për të drejtat e njeriut/fëmijëve, 15 komuna kanë ndërmarrë veprime, ndërsa 22 komuna: Deçan, Ferizaj, Malishevë, Suharekë, Klinë, Rahovec, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Gjilan, Obiliq, Prishtinë, Kamenicë, Podujevë, Viti, Kllokot, Dragash, Kaçanik, Junik, Leposaviq, Zveçan dhe Mitrovica Veriore, nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë.

Korniza ligjore për të drejtat e fëmijëve - Për zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve, 26 komuna ballafaqohen me këto vështirësi: mungesa e buxhetit, mungesa e zyrtarit për të drejtat e fëmijëve, vetëdijesimi ultë për të drejtat e fëmijëve, etj. Ndërsa 3 komuna (Kamenicë, Podujevë dhe Kllokot) nuk kanë vështirësi në zbatimin e kornizës ligjore, si dhe 8 komuna (Mamushë, Ranillug, Dragash, Mitrovica Veriore, Fushë Kosova, Leposaviq, Zveçan dhe Partesh) nuk kanë ofruar të dhëna.

Përfaqësimi i grave në institucionet lokale - Numri i përfaqësimit të grave në pozita menaxheriale në 35 komuna është 622. Ndërsa 2 komuna: Shtërpçë dhe Mitrovicë Veriore: nuk kanë ofruar informacione. Kurse, numri i përfaqësimit të grave në komunë, duke përfshirë administratën dhe Kuvendin e Komunës për 34 komuna është 3401, ndërsa 3 komuna: Shtime, Pejë dhe Mitrovica Veriore për këtë segmente nuk kanë ofruar informacion. Për këtë qëllim flet diagrami, si vijon:



Diagrami 18: Numri i përfaqësimit të grave (menaxhere dhe grave të punësuar) në institucionet lokale.

Të drejtat pronësore - Me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, 28 komuna kanë ndërmarrë veprime si: fushata sensibilizuese, tryeza, seminare për vetëdijësimin e shoqërisë, ndërsa 9 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Ferizaj, Kllokot, Junik, Leposaviq dhe Mitrovica Veriore, ende nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë.

Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore - Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, janë paraqitur 138 raste të trafikimit me qenie njerëzore në 11 komuna: Pejë, Suharekë, Vushtrri, Shtime, Istog, Mitrovicë, Fushë Kosova, Prizren, Viti, Gllgoc, Junik, ndërsa në 26 komuna tjera nuk është paraqitur ndonjë rast i trafikimit me qenie njerëzore. Gjithashtu, 11 komuna kanë siguruar ndihmë, për viktimat e komuniteteve pakicë kundër trafikimi dhe kundër dhunës në familje, ndërsa në 26 komuna tjera: Prishtinë, Kamenicë, Podujevë, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Ferizaj, Malishevë, Deçan, Klinë, Rahovec, Gjilan, Gjakovë, Lipjan, Obiliq, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë, Veriore, Partesh, Zveçan, Hani Elezit, Kllokot, Dragash,

Kaçanik, Leposaviq nuk kanë pasur raste të të tilla. Në bazë të raporteve të komunave, shohim se 18 komuna kanë ndarë buxhet për vitin 2017 për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, shuma e ndarë është 979.856.47 €, ndërsa 19 komuna, si: komunat: Kllokot, Glllogoc, Kaçanik, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Partesh, Zveçan, Vushtrri, Malishevë, Deçan, Suharekë, Mamushë, Ranillug, Shtërpcë, Istog, Podujevë, Leposaviq nuk kanë ndarë, mjete të tilla.

Rregulloret komunale për përdorim të gjuhëve zyrtare – Këtë Rregullore aktualisht e posedojnë 32 komuna. Ndërsa, 5 komuna: Ranillug, Mamushë, Mitrovica Veriore, Leposaviq dhe Zveçan, nuk e posedojnë ende.

Lidhur me këtë, stafin profesional që ka të bëjë me përkthim, 27 komuna e kanë rekrutuar stafin, ndërsa komuna 10 (Mamushë, Ranillug, Malishevë, Suharekë, Obiliq, Hani Elezit, Glllogoc, Kaçanik, Zveçan dhe Graçanicë) ende jo. Gjithashtu, 32 komuna kanë ndërmarrë veprime për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal: kanë përkthyesin, kanë rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe në ueb-faqen e komunës publikohen dokumentet në gjuhët zyrtare që përdoren etj. ndërsa 4 komuna: Mamushë, Ranillug, Malishevë dhe Juniku) nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim të tillë, ndërsa komuna e Zveçanit ende nuk ka ueb-faqe.

### 2.1.8. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore

Lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore, 21 komuna kanë ndërmarrë aktivitete si në vijim: shenjzimin e aseteve të Trashëgimisë, zonave të mbrojtura dhe kulturore etj. Ndërsa 14 komuna (Malishevë, Suharekë, Rahovec, Lipjan, Obiliq, Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë, Juniku, Mitrovica Veriore, Hani Elezit, Kllokot, Leposaviq dhe Zveçan nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim si dhe 2 komunë: Mitrovicë dhe Kamenicë nuk kanë zona të mbrojtura.

Planet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore – Bazuar nga të dhënat që posedon MAPL, Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e posedojnë 17 komuna, ndërsa 20 komuna (Gjakovë, Ferizaj, Klinë, Shtime, Novobërdë, Shtërpcë, Mamushë, Ranillug, Dragash, Kllokot, Hani Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Prishtinë, Kamenicë, Mitrovicë, Partesh, Leposaviq dhe Zveçan) ende jo.

Zonat e mbrojtura – Sa i përket numri të shkeljeve të zonave të mbrojtura, të dhënat e siguruar nga komunat pasqyrojnë se numri i shkeljeve në zonat e mbrojtura në 2 komuna: Deçan, Klinë janë 22 raste, ndërsa në 33 komuna tjera nuk kanë pasur ndonjë rast, si dhe 2 komuna: Mitrovicë dhe Kamenicë nuk kanë zona të mbrojtura. Komuna e Deçanit dhe Klinës të cilat kanë pasur raste të shkeljeve të evidentuara kanë vazhduar me procedurat penale ndaj shkelësve të ligjit dhe në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore. Ndërsa 33 komuna meqë nuk kanë shkelje në zonat e mbrojtura, nuk ka pasur masa të ndërmarra.

Masat mbrojtëse për trashëgimin kulturore - Me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore komunale, pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodoke janë vendosur në 17 komuna, ndërsa 1 komuna (Klina) këto pajisje i ka vendosur pjesërisht. Kurse, 12 komuna: Suharekë, Shtime, Mamushë, Shtërpcë, Prishtinë, Kamenicë, Mitrovicë, Mitrovica Veriore, Parteshi, Kaçanik, Kllokot dhe Viti ende jo, si dhe 7 komuna tjera, si: Malishevë, Novobërdë, Junik, Hani Elezit, Glllogoc, Dragash dhe Leposaviq nuk kanë kisha ortodokse ose nuk kanë ofruar informacione përkatëse. Gjithashtu, prej komunave që kanë Kisha Ortodokse, 11 komuna kanë memorandume bashkëpunimi, ndërsa 19 komuna: Deçan, Suharekë, Pejë, Gjilan, Obiliq, Mamush, Ranillug, Prishtinë, Kamenicë, Istog, Fushë Kosova, Prizren, Viti, Kllokot, Skenderaj, Leposaviq, Kaçanik, Zveçan dhe Partesh

nuk kanë nënshkruar ndonjë Memorandum të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë në relacion më mirëmbajtjen e Kishës Ortodokse. Kurse, komuna e Mitrovicës Veriore nuk ka ofruar informacione.

Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit - Në kuadër të koordinimit ndërinstytucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë themeluar dhe funksionojnë Këshilli për Fshatin Hoçë e Madhe dhe Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit. Në komunë e Rahovecit, Këshilli i fshatit për Hoçën e Madhe funksionon me vendim të kuvendit komunal të komunës prej vitit 2015. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, komuna e Rahovecit nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për shkak se nuk ka pasur asnjë ankesë për shkëlqje të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe. Ndërsa, në komunën e Prizrenit janë siguruar të gjitha fondet dhe materialet për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore për Qendrën historike të Prizrenit dhe kjo ka bërë që Këshilli të jetë më profesional dhe t'i ndjek të gjitha aktivitetet në Qendrën historike të Prizrenit. Komuna e Prizrenit ka caktuar gjithsejtë 2 inspektor për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Lidhur me këtë, për periudhën raportuese Janar- Dhjetor 2017, Task Forca ka bërë identifikimin e objekteve të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike. Po ashtu, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2017, 22 komuna kanë organizuar fushata për ndërgjegjësimin dhe promovimin më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. 15 komuna të tjera: Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Malishevë, Klinë, Junik, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Mitrovicë, Kllokot, Gillogoc, Dragash, Leposaviq, Zveçan dhe Kaçanik nuk kanë organizuar ndonjë fushatë të tillë. Komuna e Prizrenit ka alokuar buxhetin në vlerë prej 57,000€ për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, për të mundësuar funksionimin e suksesshëm. Ndërsa, komuna e Rahovecit ka ndarë buxhet për fshatin Hoçë e Madhe në shumë prej 22,000€.


## 2.2. Kriteret Ekonomike

### 2.2.1. Ekonomia e tregut

Procedurat administrative – Gjatë periudhës një vjeçare (janar – dhjetor, 2017) 34 komuna kanë ofruar lehtësi të shumta në procedurat administrative, si: Pa pagesë – regjistrim të bizneseve, uljen e taksave, lehtësi në regjistrimin e njësive të biznesit, Zyrtarët e Regjistrimit ju ndihmojnë në plotësimin e formularëve të nevojshëm, për çdo kërkesë të palës etj, ndërsa 1 komunë (komuna e Leposaviqit) nuk ka bërë asgjë lidhur me këtë veprim si dhe 2 komuna të tjera: Mamushë dhe Partesh pasi që nuk kanë zyre të regjistrimit të bizneseve, nuk kanë ndërmarr ndonjë veprime të kësaj natyre.

Zhvillimi i bizneseve dhe subvencionimi i tyre - Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2017, në 33 komuna numri i bizneseve të regjistruar është 9482. Ndërsa 3 komunat: Mamushë, Leposaviq dhe Partesh nuk kanë ndonjë biznes të regjistruar, si dhe komuna e Prishtinës nuk ka ofruar informacione për numrin e bizneseve të regjistruar. Sa i përket mbylljes së bizneseve, për 32 komuna numri i bizneseve të mbyllura është 1160. Ndërsa 3 komuna Mamushë, Leposaviq dhe Kllokot) nuk kanë asnjë biznes të mbyllur, si dhe 2 komuna: Partesh dhe Prishtinë nuk kanë zyre të regjistrimit të bizneseve.


Sa i përket ndarjes së buxhetit të veçantë për subvencionimin e bizneseve, është raportuar se 9 komuna kanë ndarë buxhet në shumë prej 1.009.200.00 euro, ndërsa 28 komuna (Deçan, Shtërpçë, Obiliq, Novobërdë, Klinë, Suharekë, Lipjan, Rahovec, Shtime, Pejë, Mamushë, Ranillug, Gjilan, Viti, Hani Elezit, Klllokot, Gillogoc, Dragash, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Laposaviq, Mitrovicë Veriore dhe Partesh nuk kanë ndarë buxhet. Gjithashtu, në 22 komuna janë funksionale Qendrat për promovimin e bizneseve, ndërsa në 15 komuna: Vushtrri, Lipjan, Suharekë, Pejë, Ranillug, Mamushë, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Partesh, Klllokot, Laposaviq dhe Dragash nuk janë funksionalizuar ende.



Diagrami 19: *Krahasimi i numrit te bizneseve të regjistruara dhe mbyllura sipas komunave.*

Pjesëmarrja e qytetarëve në planifikimin buxhetor - Sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në planifikimin komunal buxhetor, 32 komuna i kanë kushtuar rëndësi të veçantë përfshirjes së qytetarëve në planifikimin e buxhetit, nëpërmes këtyre formave: publikimit të projektit në ueb-faqet zyrtare të komunës, përmes takimeve me grupe të ndryshme të interesit, takimet me qytetarët, shoqata e biznesit, OJQ, grupe rinore, debateve me qytetarë etj. Ndërsa, 5 komuna: Mamushë, Pejë, Gjilan, Laposaviq dhe Zveçan, ende nuk kanë filluar procesin e përfshirjes së qytetarëve në vendim-marrje.

Luftimi i Ekonomisë Informale - Për qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal, gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2017, numri i inspektimeve për 27 komuna ka qenë 14634. Ndërsa 9 komuna: Novobërda, Shtërpçë, Obiliq, Gjilan, Prishtinë, Graçanicë, Laposaviq, Zveçan dhe Mitrovica Veriore nuk kanë pasur inspektime, si dhe komuna e Prishtinës nuk ka ofruar informacione.



Diagrami 20: Niveli i inspektimeve komunale për luftimin e ekonomisë jo formale.

Po ashtu, 30 komuna kanë ndërmarrë masa ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale, si: Inspektimi i vazhdueshëm i këtyre subjekteve, kontrollime edhe në terrene me asistimet e organeve të policisë së Kosovës, vërejtjet me procesverbal për disa biznese me qëllim të tërheqjes së vërejtjes dhe parandalimit të ekonomisë formale, ndëshkime me gjoja dhe sanksionime ligjore, konfiskime të mallit dhe ndjekjeve nga Policia, dërgimi i lëndëve në gjykatën për kundërvajtje etj. Ndërsa, 7 komuna: Laposaviq, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Gjilan, Shtërpçë Zveçan dhe Klllokot nuk kanë ndërmarrë masa pasi që nuk kanë numër të evidentuar të inspektimeve.

Funksionalizimi i Zonave Ekonomike - Sa i përket funksionalizimit të zonave ekonomike komunale, komuna e Prizrenit ka përgatitur: Planin Rregullativ të Hollësishëm “Zonë e Veçantë për Industri të Lehtë” (të mesme dhe të vogla) apo “ Parku i Biznesit”, i cili pritet të licenohet nga Ministria, Planin Rregullativ i Hollësishëm Industri e Lehtë në të cilën është kryer ri-parcelizimi, Planin Rregullativ i Hollësishëm, tregu, industri dhe banim. Ndërsa, komuna e Gjakovës nuk ka raportuar ndonjë progres në këtë drejtim.

## 2.3. Standardet Evropiane


### 2.3.1. One Stop Shop

Themelimi dhe funksionalizimi i “One Stop Shop-eve” - Të njohura ndryshe si pika të përbashkëta administrative në komuna për ofrimin e shërbimeve të bizneseve lokale, ka vazhduar edhe gjatë vitit 2017 me qëllim që shërbimet tu ofrohen të gjithë qytetarëve. Këto pika, janë themeluar dhe funksionojnë në 27 dhe pritet të themelohen edhe në 8 komuna tjera: Mamushë, Ranillug, Junik, Partesh, Klllokot, Prishtinë, Laposaviq dhe Zveçan, si dhe 2 komuna tjera: Skenderaj dhe Mitrovica Veriore nuk kanë ofruar informacione.

Me qëllim të funksionimit sa më të mirë të këtyre pikave komunale, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017, 11 komuna kanë organizuar 18 trajnime për stafin e one-stop shop, ndërsa 26 komuna (Klinë, Lipjan, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Malishevë, Mamushë, Ranillug, Glllogoc, Dragash, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Prishtinë, Skenderaj, Viti, Junik, Klllokot, Graçanicë, Zveçan, Laposaviq, Kaçanik, Partesh dhe Mitrovicë Veriore) nuk kanë organizuar ndonjë trajnim në këtë fushë. Gjithashtu, në 19 komuna janë trajnuar 39 zyrtar, ndërsa 18 komuna tjera, si: Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Mamushë, Ranillug, Glllogoc, Mitrovicë, Prishtinë, Skenderaj, Klllokot, Zveçan, Laposaviq, Kaçanik,



Mitrovica Veriore dhe Junik nuk kanë trajnuar asnjë zyrtar në këtë fushë. Diagrami në vijim pasqyron numrin e trajnimeve dhe numrin e zyrtarëve nga komunat, si vijon:



Diagrami 21: Numri i trajnimeve të organizuara nga komuna dhe numri i zyrtarëve të trajnuar lidhur me One stop shop-et.

Plani për energji eficiente - Planin për energji eficiente e posedojnë 28 komuna, ndërsa 9 komuna: Mamushë, Shtërpçë, Ranillug, Kllokot, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Dragash, Leposaviq nuk e posedojnë ende. Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2017, 13 komuna janë mbajtur 29 trajnime, ndërsa në 24 komunat: Gjilan, Gjakovë, Vushtrri, Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Ferizaj, Malishevë, Suharekë, Klinë, Pejë, Istog, Kamenicë, Prizren, Skenderaj, Viti, Hani Elezit, Junik, Kllokot, Graçanicë, Leposaviq, Zveçan, Kaçanik dhe Mitrovicë Veriore nuk është organizuar asnjë trajnim. Kurse, lidhur me aktivitetet të komunave për zbatimin e këtij plani, në 32 komuna kanë ndërmarrë aktivitete për zbatimin e planit për efizienzë të energjisë siç janë: është bërë ndërrimi i poqëve të ndriçimit publik, është vendosur sistemi i poqëve LED në disa rrugë të qytetit, është bërë rregullimi i dritareve të shkalleve sipas planit të efijencies së energjisë etj. Ndërsa 5 komuna: Pejë, Viti, Kllokot, Leposaviq dhe Skenderaj nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitetet.

### 2.3.2. Gjyqësori dhe të Drejtat e njeriut


Zbatimi i ligjit për mbrojtje nga diskriminimi - Sa i përket zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga Diskriminimi në respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, të dhënat tregojnë se ky zbatohet në 28 komuna, ndërsa në 5 komuna: Suharekë, Mamushë, Shtërpçë, Rahovec dhe Leposaviq nuk zbatohet, kurse 2 komuna, si Mitrovica Veriore dhe Skenderaj nuk kanë ofruar informatë dhe komuna e Novobërdës dhe Vitisë kanë ofruar të dhëna pjesërisht. Gjithashtu 21 komuna kanë ndërmarrë veprime për këtë fushë si: ndihma financiare përmes OJQ-ve, ndërtimi i infrastrukturës për qasje të lirë (pjerrinat, ashensorët dhe semaforët), emërimi i zyrtarit kundër diskriminimit ashtu siç e parashih ligji, Rekomandimet për institucionet publike të cilat nuk kanë rregulluar qasjen horizontale dhe të pjerrtë për personat me aftësi të kufizuar, shpërndarja e fletushkave të ndryshme etj, ndërsa 16 komuna: Rahovec, Mamushë, Shtërpçë, Gjilan, Lipjan, Obiliq, Shtime, Kllokot, Prishtinë, Skenderaj, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Leposaviq, Zveçan, Kaçanik dhe Podujevë nuk kanë ndërmarrë veprime për zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga Diskriminimi.

Ofrimi i ndihmës juridike falas – Sipas të dhënave nga MAPL, në 6 komuna është funksionalizuar zyra për ndihmë juridike, ndërsa në 27 komuna: Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Malishevë, Deçan, Klinë, Rahovec, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Glllogoc, Dragash, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Podujevë, Junik, Graçanicë, Leposaviq, Zveçan, Partesh dhe Fushë Kosovë ende jo, si dhe 4

komuna tjera: Skenderaj, Mitrovicë Veriore, Mitrovicë dhe Kaçanik nuk kanë ofruar informatë. Lidhur me rekrutimin e zyrtarëve për ndihmë juridike falas, gjatë kësaj periudhë 6 komuna kanë bërë rekrutimin e zyrtarëve për ndihmë juridike falas ndërsa në 20 komuna: Malishevë, Deçan, Klinë, Rahovec, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpcë, Viti, Kllokot, Glllogoc, Podujeva, Junik, Graçanica dhe Partesh nuk e kanë bërë një gjë të tillë, si dhe 11 komuna: Hani Elezit, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Zveçan, Leposaviq, Kaçanik dhe Mitrovicë Veriore nuk kanë ofruar informatë.

Mbrojtja e të dhënave personale - Sa i përket fushës së mbrojtjes së të dhënave personale në 36 komuna, është caktuar zyrtari përkatës komunal për mbrojtjen e të dhënave personale ndërsa në 1 komunë (Zubin Potok) ende nuk është caktuar. Po ashtu, baza e të dhënave personale është funksionalizuar në 21 komuna, ndërsa në 15 komuna: Deçan, Gjakovë, Vushtrri, Peja, Suharekë, Klinë, Mamushë, Ranillug, Glllogoc, Hani Elezit, Skenderaj, Istogu, Kamenicë, Leposaviq dhe Kaçanik nuk është funksionalizuar ende, si dhe në komunën e Graçanicës është funksionalizuar pjesërisht.

Siguria fizike e dokumentacionit - Sigurinë fizike të dokumentacionit (roja fizike, vendosja e kamerave, grilat dhe kasafortat, etj.) e kanë përmirësuar 33 komuna, ndërsa 2 komuna: Mamushë, Rahovec nuk e kanë ngritur sigurinë fizike për dokumentacion, si dhe 2 komunë (Klinë dhe Kamenicë) pjesërisht. Po ashtu, në 35 komuna mbahen libra fizik, ndërsa 2 komuna: Mamushë dhe Ranillug nuk mbahen. Në kuadër të funksionimit të zyrave komunale për komunitetet dhe Kthim, në 36 komuna bëhet verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar nga zyrtari për kthim dhe komunitetet dhe lënda shqyrtohet në Komisionin Komunal për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Ndërsa, në një (1) komunë (Novobërdë) një gjë e tillë nuk bëhet.



Diagrami 22: Numri i personave të rikthyer dhe shtëpitë e ndërtuar sipas komunave.

Bazuar nga ky diagram mund të shohim se numri i personave të kthyer dallon dukshëm nga komuna në komunë, megjithëse sfiduese mbetet ndërtimi i shtëpive për të kthyerit. Mund të shohim se komuna e Shtërpcës prin për nga numri i personave të zhvendosur me gjithsej 500 persona, duke u pasuar nga komuna e Ferizajt me 440 persona e kështu me radhë. Lidhur me personat e kthyer dhe regjistrimin e tyre në komunat përkatëse, në 30 komuna numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën është 2841, ndërsa 7 komuna: Shtime, Prishtinë, Viti, Graçanicë, Partesh, Leposaviq dhe Mitrovica Veriore nuk kanë persona të rikthyer. Po ashtu në 11 komuna numri i shtëpive të rindërtuar për të rikthyerit është 47, ndërsa në 26 komuna: Deçan, Gjilan, Klinë, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtime, Ferizaj, Malishevë, Mamushë, Ranillug, Glllogoc, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Podujevë, Partesh, Skenderaj,


Viti, Hani Elezit, Junik, Prishtinë, Mitrovica Veriore, Kllokot, Leposaviq, Kaçanik, Graçanicë nuk ka shtëpi të rindërtuar për të rikthyerit.

Aplikimet për asistencë financiare dhe për biznese - Në 26 komuna numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim është 962, ndërsa 11 komuna (Klinë, Rahovec, Shtime, Ferizaj, Mamushë, Junik, Partesh, Mitrovica Veriore, Leposaviq, Kaçanik dhe Zveçan) nuk kanë pasur, si dhe në 32 komuna numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riadhesuar është 1064, ndërsa 5 komuna: Novobërdë, Partesh, Leposaviq, Zveçan dhe Mitrovica Veriore nuk kanë pasur.

Pajisja me dokumentet e nevojshme personat e riadhesuar - Me qëllim të pajisjes me dokumente të nevojshme të personave të nevojshme të riadhesuar, në 12 komuna kanë pasur 209 raste, ndërsa 25 komuna: Gjilan, Klinë, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtime, Shtërpcë, Ferizaj, Vushtrri, Malishevë, Ranillug, Skenderaj, Junik, Mitrovicë Veriore, Partesh, Istog, Podujevë, Mitrovicë, Prizren, Viti, Glllogoc, Leposaviq, Kaçanik, Zveçan dhe Dragash nuk kanë pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar të cilat janë pajisur me dokumente personale.

Planet Lokale të Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE - Planin Lokal të Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE e kanë miratuar 13 komuna, ndërsa 17 komuna: Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë, Klinë, Rahovec, Pejë, Gjakovë, Shtime, Viti, Kllokot, Dragash, Zveçan, Fushë Kosovë, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore dhe Leposaviq ende jo, si dhe 7 komuna tjera, si: Ranillug, Glllogoc, Junik, Hani Elezit, Kaçanik, Zveçan dhe Partesh nuk kanë komunitete RAE.

Regjistrimi i Komunitetit RAE - Në 17 komuna numri i personave të regjistruar nga komuniteti RAE është 3831, ndërsa 13 komuna: Dragash, Istog, Kamenicë, Leposaviq, Podujevë, Prizren, Skenderaj, Mamushë, Mitrovicë Veriore, Novobërdë, Prishtinë, Ferizaj, Rahovec) nuk kanë persona të regjistruar nga komunitetet RAE, si dhe 7 komuna: Ranillug, Glllogoc, Kaçanik, Junik, Hani Elezit, Zveçan dhe Partesh nuk kanë RAE. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe në 9 komuna janë mbajtur 18 fushata për regjistrim falas, ndërsa në 21 komuna: Gjakovë, Klinë, Lipjan, Pejë, Shtërpcë, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Ranillug, Leposaviq, Istog, Kamenicë, Mitrovicë, Podujevë, Viti, Kllokot, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Veriore dhe Prizren nuk janë mbajtur fushata për regjistrim falas, si dhe 7 komuna: Ranillug, Glllogoc, Kaçanik, Junik, Hani Elezit, Zveçan dhe Partesh nuk kanë pjesëtarë të komunitetit RAE në komunën e tyre.



Diagrami 23: Numri i personave të regjistruar nga radhët e komunitetit RAE sipas komunave.

### 2.3.3. Drejtësia, Liria dhe Siguria

Planet lokale të veprimit për riintegrim – Të dhënat nga MAPL tregojnë se 35 komuna kanë miratuar Planin Lokal të Veprimit për Ri-integrim, ndërsa 2 komuna (Leposaviq, dhe Mitrovicë Veriore) ende nuk e kanë miratuar këtë plan.

Digjitalizimi i librave të gjendjes civile - Në 21 është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia, ndërsa 13 komuna: Mamushë, Ranillug, Lipjan, Deçan, Rahovec, Gjakovë, Skenderaj, Mitrovica Veriore, Kllokot, Dragash, Podujevë, Leposaviq dhe Zveçan ende nuk kanë përfunduar, si dhe 1 komunë, komuna e Vushtrrisë ky proces ka përfunduar pjesërisht. Kurse, 2 të tjera komuna e Prishtinës dhe Istogut nuk kanë ofruar informata. Lidhur me këtë, në 30 komuna numri i zyrtarëve komunal që janë certifikuar që u janë nënshkruar testit të njohurive ligjore/procedurale dhe të sistemit është 482, ndërsa 7 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Rahovec, Partesh, Zveçan dhe Leposaviq nuk kanë zyrtar të certifikuar.

### 2.3.4. Migracioni

Këshilli Lokal për Siguri Publike - Në 33 janë funksionalizuar KLSP-të, kure 4 komuna: Gjilan, Junik, Kaçanik dhe Hani Elezit nuk kanë themeluar ende. Ekipet Vepruese për siguri në komuna janë themeluar në 33 komuna, ndërsa 3 komuna (Gjilan, Kllokot dhe Kaçanik) nuk e kanë themeluar ende si dhe 1 komunë (Mitrovica Veriore) nuk ka ofruar informacione. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, në 23 komuna janë mbajtur 95 takime, ndërsa 2 komuna (Glllogoc dhe Dragash) nuk kanë ofruar informacione. Në 12 komuna: Gjilan, Lipjan, Shtime, Novobërdë, Mamush, Hani Elezit, Mitrovica Veriore, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Leposaviq dhe Mitrovicë nuk është mbajtur asnjë trajnim. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, 23 komuna kanë ndërmarrë këto aktivitete: kanë aprovuar planin vjetor të punës, mbajtja e tryezës të rumbullakët për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, Mbajtja e Ligjëratave me nxënës të dy shkollave të mesme lidhur me mjetet shpërthyes - bartës i aktivitetit ka qenë FSK-ja lidhur me substancat narkotike etj. Ndërsa 14 komuna: Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Prishtinë, Kamenicë, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Skenderaj, Leposaviq, Zveçan dhe Mitrovica Veriore nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.


Luftimi i narkotikëve - Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, 27 komuna kanë ndërmarrë këto aktivitete për arritjen e rezultateve në luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve: Pedagogët dhe Psikologët në shkolla kanë mbajtur ligjëratat të vazhdueshme lidhur me këto dukuri, komunat kanë bashkëpunuar me Policinë për identifikimin e vendeve ku përdoren substanca narkotike etj, ndërsa 10 komuna: Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Prishtinë, Mitrovica Veriore, Partesh, Kllokot, Dragash, Zveçan dhe Leposaviq) nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet konkret në këtë drejtim.

### 2.3.5. Arsimi dhe Kultura

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve teknike për arsimin gjithëpërfshirës, komuna e Prishtinës ka pajisur me teknologji informative Qendrën për Këshillim në Karrierë Funksionale. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, 29 komuna kanë ndërmarrë këto aktivitete që kanë rritur edukimin mbi shëndetin: fushata vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis, shënimi i ditës botërore të Kancerit të qafës së mitrës, shënimi i ditës së kancerit të prostatës, shënimi i ditës të luftës kundër duhanit, shënimi i Javës së Imunizimit ku janë mbajtur ligjëratat, janë shpërndarë fletushka, aktivitetet e vazhdueshme me Organizatën "Save the Children", ndërsa 8 komuna: Novobërdë, Shtërpçë, Graçanica, Mitrovica Veriore, Kllokot, Kaçanik, Zveçan dhe Leposaviq nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.


Zbatimi i udhëzuesit për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta - Në 28 komuna është zbatuar udhëzuesi për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësim-nxënie, ndërsa 8 komuna: Klinë, Mamushë, Shtërpçë, Mitrovica Veriore, Partesh, Kllokot, Dragash dhe Leposaviq nuk kanë zbatuar ende, si dhe komuna e cila nuk ka përmbushur këto obligime<sup>5</sup>. Gjithashtu, në 18 komuna është hartuar pakoja e materialeve për informimin e prindërve rreth rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, ndërsa në 19 komuna: Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Shtime, Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Klinë, Rahovec, Pejë, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Kllokot, Dragash dhe Leposaviq ende nuk është hartuar pakoja e materialeve përkatëse.

Institucionet parashkollore – Gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017, në 31 komuna në institucionet parashkollore janë përfshirë gjithsejtë 16895 fëmijë. Ndërsa në 2 komuna: Mamushë dhe Gjilan nuk ka fëmijë të cilët janë të përfshirë në institucionet parashkollore. Kurse 4 komuna të tjera, si: Dragash, Kllokot, Leposaviq dhe Mitrovica Veriore nuk kanë ofruar informatë.



Diagrami 24: Numri i nxënësve parashkollor sipas komunave.

Braktisja e shkollimit nga komuniteti RAE – Lidhur me braktisjen e shkollimit të komuniteti RAE, kemi:



Diagrami 25: Numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti RAE sipas komunave.


Siç mund të vërejme nga diagrami në fjalë, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, në 8 komuna numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë është 283 nxënës, ndërsa 22 komuna: Deçan, Gjilan, Lipjan,

<sup>5</sup> Përgjigjet nuk kanë qenë kredibile dhe kanë qenë të paqarta, si dhe kjo komunë nuk i është përgjigjur kërkesës MAPL-së për sqarime.

Novobërdë, Obiliq, Shtime, Shtërpçë, Suharekë, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Dragash, Mitrovicë, Podujevë, Prizren, Skenderaj, Viti, Klllokot, Graçanicë, Klinë Mitrovica Veriore dhe Leposaviq nuk kanë nxënës që kanë braktisur shkollimin, si dhe 7 komuna tjera: Ranillug, Kaçanik, Glllogoc, Junik, Hani Elezit, Zveçan dhe Partesh nuk kanë fare RAE në komunën e tyre. Gjithashtu, 25 komuna kanë ndërmarr aktivitete senzibilizuese për nxënës dhe prindër, lidhur me pasojat e migrimit, ndalimin e braktisjes së shkollimit. Ndërsa 12 komuna: Gjilan, Malishevë, Suharekë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Mitrovica Veriore, Partesh, Prizren, Klllokot, Leposaviq dhe Zveçan nuk kanë ndërmarrë ndonjë aktivitet.

### 2.3.6. Mjedisi

Plani për menaxhimin e mbeturinave - Planin për menaxhimin e mbeturinave 30 komuna e kanë miratuar, ndërsa 7 komuna: Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Leposaviq dhe Zveçan ende nuk e kanë miratuar. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, në 23 komuna numri i punëtorëve të organizuar për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina është 88, ndërsa 14 komuna: Deçan, Gjakovë, Gjilan, Novobërdë, Pejë, Shtime, Shtërpçë, Mamushë, Kamenicë, Viti, Junik, Graçanicë, Leposaviq dhe Mitrovica Veriore nuk kanë organizuar ndonjë punëtor. Gjithashtu, në 29 komuna, janë trajnuar gjithsej 109 zyrtar, ndërsa 8 komuna: Gjilan, Novobërdë, Pejë, Shtërpçë, Mamushë, Kaçanik, Mitrovica Veriore dhe Leposaviq nuk kanë ndonjë zyrtar të trajnuar.




Diagrami 26: Numri i punëtorëve, stafit të trajnuar dhe numri i fushatave që lidhen me planet komunale dhe rregulloret për mbeturina sipas komunave për vitin 2017.

Fushatat e ndërmarra nga komunat për sistemin e menaxhimit të mbeturinave - Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, për 22 komuna, numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave është 94, ndërsa 15 komuna: Gjilan, Klinë, Novobërdë, Shtërpçë, Pejë, Suharekë, Mamushë, Kamenicë, Istog, Podujevë, Prishtinë, Skenderaj, Junik, Graçanicë dhe Mitrovica Veriore nuk kanë mbajtur fushata për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Po ashtu, vlerësimin dhe planin reformues të sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta e kanë përgatitur 18 komuna, ndërsa 19 komuna: Novobërdë, Mamushë, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Shtime, Suharekë, Rahovec, Pejë, Podujevë, Parteshi, Mitrovica Veriore, Viti, Skenderaj, Hani Elezit, Leposaviq, Zveçan dhe Kaçanik nuk kanë përgatitur vlerësimin dhe planin reformues të sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta. Lidhur me këtë, në komunën e Dragashit studimi i parafizibilitetit për deponinë e mbeturinave komunale ka përfunduar, ndërsa në komunën e Gjilanit ende nuk është përfunduar.

Inventari për mbeturina të rrezikshme - Inventarin për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimin e gjendjes për mbeturina të rrezikshme e kanë përgatitur 6 komuna, ndërsa 31 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Gjilan, Gjakovë, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Shtime, Ferizaj, Deçan, Suharekë, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Prizren, Viti, Hani Elezit, Kllokot, Glllogoc, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Zveçan dhe Partesh nuk e kanë përgatitur ende.

Programi për mbrojtje të ujërave - Gjatë periudhës raportuese Janar- Dhjetor 2017, në Planin rregullues detajor 14 komuna kanë përfshirë zonat e mbrojtura ujore sanitare, ndërsa 23 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Gjilan, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Malishevë, Suharekë, Rahovec, Pejë, Kaçanik, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Kllokot, Dragash, Leposaviq, Zveçan dhe Kaçanik nuk e kanë përfshirë.

Deponitë ilegale - Në 30 komuna numri i deponive ilegale është 1086. Ndërsa 7 komuna: Shtime, Malishevë, Dragash, Prishtinë, Partesh, Leposaviq dhe Mitrovica Veriore nuk kanë ofruar të dhëna. Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, në 23 komuna janë mbajtur 52 punëtori, ndërsa 14 komuna: Suharekë, Pejë, Gjakovë, Shtërpçë, Ranillug, Mamushë, Novobërdë, Kaçanik, Podujevë, Fushë Kosova, Skenderaj, Junik, Mitrovica Veriore, Leposaviq nuk kanë mbajtur ndonjë punëtori. Në 28 komuna janë trajnuar 77 zyrtar mjedisor komunal, ndërsa 9 komuna: Pejë, Novobërdë, Mamushë, Kaçanik, Fushë Kosovë, Skenderaj, Zveçan, Leposaviq dhe Junik nuk kanë zyrtar mjedisor komunal që janë trajnuar.



Diagrami 27: Numri i deponive ilegale sipas komunave.

### 2.3.7. Bujqësia Lokale

Inspektorët e bujqësisë lokale - Gjatë periudhës raportuese Janar- Dhjetor 2017, 18 komuna kanë inspektor të bujqësisë ndërsa 19 komuna: Novobërdë, Mamushë, Ranillug, Shtërpçë, Obiliq, Ferizaj, Malishevë, Pejë, Vushtrri, Istog, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Mitrovica Veriore, Partesh, Hani Elezit, Dragash, Kaçanik, Zveçan dhe Glllogoc nuk kanë inspektor të bujqësisë.

Masat komunale për mbrojtjen e tokës bujqësore - Në kuadër të masave komunale për mbrojtjen e tokës bujqësore, gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2017, në 19 komuna numri i kërkesave të parashtruara është 4009, ndërsa 18 komuna: Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtërpçë, Suharekë, Vushtrri, Mamushë, Ranillug, Dragash, Istog, Mitrovica, Podujevë, Skenderaj, Hani Elezit, Zveçan, Leposaviq, Kaçanik dhe Mitrovica Veriore nuk kanë pasur kërkesa të parashtruara. Për 14 komuna numri i lejeve të lëshuara është 333, ndërsa 23 komuna: Deçan, Gjilan, Klinë, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtërpçë, Suharekë,

Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Glllogoc, Dragash, Istog, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Podujevë, Hani Elezit, Mitrovica Veriore, Kaçanik, Zveçan, Leposaviq dhe Junik nuk kanë pasur ndonjë leje.

Numri i inspektimeve dhe fletëparaqitjeve – Gjatë periudhës raportuese Janar- Dhjetor 2017, në 21 komuna numri i inspektimeve është 5546 ndërsa 16 komuna: Dragash, Kaçanik, Mitrovicë, Leposaviq, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Podujevë, Shtërpcë, Ferizaj, Vushtrri, Zveçan, Hani Elezit, Mamushë, Ranillug, Mitrovicë Veriore, nuk ka pasur inspektime. Numri i fletëparaqitjeve të parashtruara në 15 komuna është 964 ndërsa 22 komuna: Deçan, Gjilan, Novobërdë, Rahovec, Pejë, Shtërpcë, Ferizaj, Vushtrri, Malishevë, Mamushë, Dragash, Mitrovicë, Podujevë, Skenderaj, Viti, Hani Elezit, Junik, Klllokot, Leposaviq, Zveçan, Kaçanik dhe Mitrovica Veriore nuk e kanë pasur fletëparaqitje të parashtruara.

Plani për menaxhimin e tokave rurale – Të dhënat tregojnë se Planin për Menaxhimin e tokave rurale e posedojnë 11 komuna, ndërsa 26 komuna: Gjilan, Gjakovë, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Deçan, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Mamushë, Prizren, Viti, Hani Elezit, Klllokot, Glllogoc, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Mitrovicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Mitrovica Veriore dhe Partesh nuk e posedojnë ende.

### 2.3.8. Bashkëpunimi Ndërkomunal dhe Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndër komunal - Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2017, në 7 komuna: Shtërpcë, Viti, Klllokot, Vushtrri, Obiliq, Rahovec dhe Gjilan janë arritur 5 marrëveshje të bashkëpunimit ndër-komunal. Ndërsa, 31 komuna tjera: Glllogoc, Fushë Kosovë, Lipjan, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Graçanicë, Dragash, Prizren, Suharekë, Malishevë, Mamushë, Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Pejë, Junik, Leposaviq, Mitrovicë, Skenderaj, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore, Kaçanik, Kamenicë, Novobërdë, Ferizaj, Partesh, Hani i Elezit, Ranillug nuk kanë arritur gjatë vitit 2017 asnjë marrëveshje të bashkëpunimit ndër komunal.

Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar – Sa i përket bashkëpunimit komunal ndërkombëtar gjatë vitit 2017 në 4 komuna janë arritur 5 marrëveshje të binjakëzimeve: 2 në komunën e Rahovecit dhe nga 1 marrëveshje në komunat: Pejë, Prizren, dhe Suharekë. Ndërsa, 34 komuna: Glllogoc, Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Shtime, Graçanicë, Dragash, Malishevë, Mamushë, Deçan, Gjakovë, Istog, Klinë, Junik, Leposaviq, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Zubin Potok, Zveçan, Mitrovicë Veriore, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Novobërdë, Shtërpcë, Ferizaj, Viti, Partesh, Hani i Elezit, Klllokot, Ranillug nuk kanë lidhur asnjë marrëveshje bashkëpunimi komunal ndërkombëtar gatë vitit 2017.

### 2.3.9. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik

Për mbrojtjen dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës, 22 komuna kanë organizuar 100 trajnime, ndërsa 15 komuna: Novobërdë, Mamushë, Shtërpcë, Malishevë, Rahovec, Klllokot, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Prishtinë, Fushë Kosova, Leposaviq dhe Zveçan nuk kanë organizuar trajnime të tilla.



### 3. Financat Lokale

#### 3.1. Planifikimi i të Hyrave Vetanake

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2017 është në vlerë prej 78,163,490.00€, kurse me vitin 2016 ka qenë në vlerë prej 79,622,353.00 €, që është më i vogël për 1,458,863.00 ose për 1.83%.

#### 3.2. Realizimi i të Hyrave Vetanake

Komunat e Republikës së Kosovës të hyrat vetanake i mbledhin në dy forma: të hyra të mbledhura drejtpërdrejt nga komuna si aktivitet i komunës dhe të hyrat e arkëtuara nga niveli qendror të cilat transferohen në komuna si pjesë përbërëse e të hyrave vetanake.

Realizimi i të hyrave direkte dhe indirekte për vitin 2017 ka qenë 72,529,276.75 €, që nëse krahasojmë me planifikimin e 78,163,490.00 €, atëherë i bie që realizimi është 93%. Mbledhja e të hyrave vetanake direkte për vitin 2017 në vlerë prej 67,476,446.60 € krahasuar me vitin 2016 në vlerë prej 66,230,620.97 € është më i madh për 1,245,825.63€ ose një rritje prej 1.88 % €.

Duke marrë për bazë të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës – SIMFK, Departamenti i Thesarit – MF. Komunat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës janar–dhjetor 2017 kanë grumbulluar prej 67,476,446.00€ të hyra vetanake direkte, ose 86.33% nga niveli i planifikuar vjetor 78,163,490.00€.

Komunat të cilat kanë realizuar më së shumti të hyra vetanake mbi 100% janë komunat: Prizren, Skenderaj, Hani i Elezit, Kllokot dhe Partesh ndërsa komunat që kanë realizuar të hyra vetanake në një shkallë të ulët nën 20% janë komunat: Zubin Potok dhe Mitrovicë Veriore. Të hyrat që kanë një ndikim më të madh në rritjen e të hyrave vetanake janë tatimi në pronë i cili gjatë vitit 2017 është inkasuar në shumë prej 22,562,501.00 €, që është një inkasim më i vogël për 2,874,142.00 € se në periudhën e njëjtë të vitit 2016 e cila ka qenë 25,436,643 €, si dhe të hyrat komunale për leje ndërtimi ku gjatë vitit 2017 është inkasuar shuma prej 18,614,038 € që është një inkasim më i madh së gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2016 e cila ka qenë 17,293,233 €. Ndërsa, të hyrat nga ndërrimi, destinimi i tokës në vitin 2017 janë të inkasuar 3,106,348.00 €, ku shihet se ka pas një rritje krahasuar me vitin 2016 me 1,707,936 €.

#### 3.3. Buxhetimi Komunal për vitin 2017


Bazuar në të dhënat zyrtare nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) - Departamenti i Thesarit - Ministria e Financave, Komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2017 i kanë shpenzuar buxhetet e tyre në vlerë të përgjithshme prej 419,327,289.09 ose 90% e buxhetit të planifikuar në vlerë prej 466,567,443.76 €. Bazuar në gjendjen e fundit të raporteve vjetore në SIMFK buxhetimi i komunave për vitin 2017 është më i madh për 22,779,621.53 €, krahasuar me vitin 2016. Në vitin 2017 buxhetimi ka qenë 466,567,443.76 €, ndërsa në vitin 2016 buxhetimi ka qenë 443,787,822.23 €.

#### 3.4. Shpenzimet Krahasuar me Buxhetimin

Buxheti i komunave të Republikës së Kosovës sipas kategorive ekonomike në përgjithësi është shpenzuar si vijon:

- Kategoria e rrogave dhe pagave është planifikuar në vlerë prej 251,176,747.18 €, ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 247,642,405.64 €, ose 99%;
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve është planifikuara në vlerë prej 42,190,977.62 € ndërsa është shpenzuar në vlerë prej 38,001,596.95 € ose 90%;
- Shpenzimet komunale të planifikuara në vlerë prej 10,114,176.26 € janë shpenzuar 9,316,628.52 €, ose 92%;
- Subvencione dhe transfere të planifikuara në vlerë prej 9,617,467.73€ janë shpenzuar 8,636,162.51€ ose 90%; dhe
- Kategoria e shpenzimeve kapitale të planifikuara në vlerë prej 153,468,065.97 € është shpenzuar 115,730,495.47 €, ose 75%.

Nëse i krahasojmë kategoritë ekonomike atëherë shohim se kategoria e rrogave dhe pagave është shpenzuar më së shumti deri 99%, ndërsa më së paku është shpenzuar kategoria e shpenzimeve kapitale (75%) krahasuar me buxhetimin. Në vijim kemi paraqitur diagramin i cili shpjegon krahasimin në mes të planifikimeve dhe shpenzimeve të buxheteve komunale sipas kategorive buxhetore, si vijon:



Diagrami 28: Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit sipas kategorive në komuna.

Kurse, sa i përket shprehjes në përqindjes, shpenzimet buxhetore sipas kategorive janë, si vijon:

- Kategoria e rrogave dhe pagave krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 36 komuna prej 90% - 100% ndërsa në 2 komuna është shpenzuar (48% Mitrovica e Veriut kurse 49% në Zveçan).
- Kategoria e mallrave dhe shërbimeve krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin nga 90% - 100% në 17 komuna ndërsa në 11 komuna në nivelin prej 85% - 90% si dhe 10 nga 66%deri ne 84%.
- Kategoria e Shpenzimeve Komunale krahasuar me buxhetimin është shpenzuar në nivelin 91% - 100% në 25 komuna; në 2 komuna është shpenzuar në nivelin 85% - 90%, si dhe 11 komuna nga 31% - 84%.

- Kategoria e Subvencioneve dhe transfereve krahasuar me planifikimin është shpenzuar në nivelin 90% - 100% në 27 komuna në 7 komuna është shpenzuar në nivelin 79% – 89%, në 4 komuna është shpenzuar në nivelin 43% – 77%.
- Kategoria e Shpenzimeve kapitale (pasuritë jofinanciare) krahasuar me planifikimin është shpenzuar në 4 komuna 90% - 98%, në 13 komuna është shpenzuar 80% – 89%, në 14 komuna është shpenzuar 61% – 78%, si dhe në 7 komuna është shpenzuar 12% - 59%.

Komunat të cilat kanë arritur të shpenzojnë në total buxhetin në nivel më të lartë prej 91% - 99% të nivelit vjetor të buxhetuar janë 23 komuna, në 10 komuna është shpenzuar 80% - 90% dhe në 5 komuna janë shpenzuar 56% - 75%.

### 3.5. Opinioni i Auditorit për Komunat e Republikës së Kosovës

Opinionet e auditorit për komuna janë të ndryshme sipas viteve, ku mund themi se lloji i opinionit i cili më së shumti është dhënë në vitet 2015-2016 është opinion pamodifikuar me theksim të çështjes i cili është dhënë në 22 komuna në vitin 2015 dhe në 33 komuna në vitin 2016, pastaj opinionin i kualifikuar – me theksim të çështjes i cili është dhënë në 9 komuna për vitin 2015, ndërsa për vitin 2016 këtë lloj opinionin e kanë pranuar 4 komuna; opinion të kualifikuar në vitin 2015 kanë pranuar 2 komuna. Ndërsa, në vitin 2016 asnjë komunë nuk ka pranuar këtë lloj opinionin. Opinion të kundërt në vitin 2015 kanë marrë 4 komuna, ndërsa në vitin 2016 nuk ka marrë asnjë komunë, opinionin i pamodifikuar në vitin 2015 ka marrë 1 komunë, si dhe në vitin 2016 ka marrë vetëm 1 komunë. Opinionin i cili ju mundëson komunave për të filluar me procedura të huas komunale duhet të kenë dy vite radhazi (dy vitet e fundit) opinionin i pamodifikuar të cilin ka marrë Lipjani në vitin 2015 ndërsa komuna e Vitis në vitin 2016. Plotësimin e kriterit për marrjen e huas komunale, sipas raportit të fundit për dy vite radhazi nuk e plotëson asnjë komunë. Në vijim mund të shihni pasqyrën me të dhëna lidhur me këto opinione të auditorit sipas komunave dhe sipas viteve.

Opinionin i auditorit	Vitet	Komunat
Opinionin i pamodifikuar	2015	Lipjan, (1 komunë)
	2016	Viti, (1 komunë)
Opinionin i pamodifikuar me Theksim të çështjes	2015	Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Pejë, Gjakovë, Podujevë, Vushtrri, Suharekë, Glogoc, Malishevë, Rahovec, Istog, Klinë, Kamenicë, Shtime, Obiliq, Hani i Elezit, Novobërdë, Mamushë, Ranillugë, Kllokot (22 komuna)
	2016	Gjakovë, Junik, Vushtrri, Glogoc, Skenderaj, Deçan, Istog, Dragash, Prishtina, Pejë, Kamenicë, Klinë, Ferizaj, Hani i Elezit, Graçanicë, Fushë -Kosovë, Mitrovicë, Shtërpçë, Shtime, Rahovec, Prizren, Partesh, Ranillug, Novobërdë, Gjilan, Kaçanik, Zubin Potok, Obiliq, Podujevë, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Lipjan (33 komuna)
Opinionin i kualifikuar me Theksim të çështjes	2015	Mitrovicë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Shtërpçë, Partesh, Skenderaj, Viti, Deçan, Junik, (9 komuna)
	2016	Kllokot, Mitrovica e Veriut, Zveçan, Leposaviq (4 komuna)
Opinionin i kualifikuar	2015	Dragash, Kaçanik, (2 komuna)

	2016	
Opinion i kundërt	2015	Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan (4 komuna)
	2016	

Tabela 3: Pasqyron opinionin e Auditorit për komunat e Republikës së Kosovës 2015 – 2016.

## Përfundime të përgjithshme

Bazuar nga raporti të cilin e kemi elaboruar deri më tani mund të arrijmë deri tek disa përfundime konkrete të komunave për vitin 2017, si:

- Gjatë vitit 2017, Kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë përmbushur normën ligjore për mbajtjen e së paku 10 takimeve brenda një viti;
- Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqes zyrtare të komunës shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik;
- Komitetet e obligueshme kanë qenë funksionale në të gjitha komunat, duke realizuar mandatin e tyre në përputhje me legjislacionin përkatës;
- Komunat kanë themeluar një numër të konsiderueshëm të komiteteve konsultative, si mundësi e mirë për përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes;
- Mbledhjet inauguruese janë mbajtur në të gjitha komunat, me ftesë nga kryetarët e zgjedhur. Në të gjitha komunat kanë dhënë betimin anëtarët e kuvendeve dhe kryetarët e komunave. Përveç dhënies së betimit nga anëtarët e kuvendeve dhe kryetarët e komunave, kuvendet komunave kanë zgjedhur edhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës;
- Me përjashtim të një rasti i cili nuk ka raportuar para kuvendeve të komunës dhe disa komunave të tjera të cilat kanë raportuar vetëm nga njëherë, të gjithë kryetarët e komunave tjera kanë përmbushur detyrimet për raportim para kuvendeve të komunave;
- Obligimi për mbajtjen e së paku 2 tubimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarë është përmbushur në 27 komuna;
- Lidhur me publikimin e akteve të miratuara në faqet zyrtare të komunës, pjesa më e madhe e komunave kanë publikuar këto akte, kurse disa komuna kanë pasur probleme teknike me funksionalizimin e faqeve zyrtare të tyre;
- Kuvendet e komunave kanë qenë aktive në hartimin e akteve nënligjore;
- Edhe gjatë vitit 2017 janë evidentuar disa raste të shkeljeve ligjore me rastin e nxjerrës së këtyre akteve;
- Prej 23 akteve të kundërligjshme, komunat kanë harmonizuar me ligj vetëm 7 akte pas kërkesës për rishqyrtim, ndërsa 16 akte mbesin për t'u harmonizuar;
- Këshilli komunal për siguri në bashkësi është themeluar në 34 komuna, ndërsa nuk është themeluar në Komunat: Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok;
- Gjatë vitit 2017 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin 67% të aktiviteteve në fushën e kritereve politike. Kurse, sa i përket përmbushjes së kritereve ekonomike, komunat kanë arritur që t'i përmbushin 75% të kritereve dhe në fushën e standardeve evropiane, ato kanë

realizuar 61% të aktiviteteve. Niveli i përgjithshëm i përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për vitin 2017 është 67%.

- Sa i përket menaxhimit buxhetor, komunat kanë treguar një performancë të mirë, megjithëse vërehet se rënie e lehtë e planifikimit të të hyrave vetanake në raport me vitin e kaluar. Në përgjithësi, komunat kanë arritur që të realizojnë rreth 93% të të hyrave vetanake. Kurse, shpenzimi i buxhetit në total është arritur që të shpenzohet 90% nga buxhetimi.
- Kategoria e shpenzimeve kapitale është shpenzuar në masë më të ulët se kategoritë tjera buxhetore.
- Tri kategoritë që kanë ndikuar më së shumti në krijimin e të hyrave vetanake në komuna kanë qenë: tatimi në pronë, të hyrat nga lejet ndërtimore dhe ndërrimi i destinimit të tokës komunale.
- Plotësimin e kriterit për marrjen e huas komunale, sipas raportit të fundit për dy vite rradhazi nuk e plotëson asnjë komunë

## Rekomandime

- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në komunat: Pejë, Klinë, Junik, Mamushë, Malishevë, Suharekë, Graçanicë, Ranillug dhe Kllokot;
- Kryetarët e komunave: Klinë, Pejë, Deçan, Junik, Mamushë, Suharekë, Gllogoc dhe Gjakovë të dërgojnë listën e akteve të miratuara nga Kryetari i Komunës konform nenit 80.1 të LVL-së;
- Aktet e Komunës të hartohen konform Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave;
- Të themelohen Komitetet Konsultative në komunat në të cilat ende nuk janë themeluar;
- Aktet e organeve të komunave të vlerësuara nga organi mbikëqyrës si të kundërligjshme, t'i rishqyrtojnë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të kërkesës;
- Me rastin e miratimit të vendimeve për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim të respektohen procedurat ligjore ashtu siç përcakton Ligji Nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, si dhe Rregulloren QRK Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës;
- Komunat të bëjnë publikimin e akteve të kuvendeve të komunave edhe në gjuhët zyrtare siç është përcaktuar në Rregulloren Nr.01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Komunat të vazhdojnë të njoftojnë me kohë MAPL-në për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi të funksionalizohet ashtu siç është paraparë me U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB;
- Të respektohen dispozitat ligjore lidhur me dërgimin e procesverbaleve nga mbledhjet e KKSB-ve në MAPL dhe MPB sipas U.A. Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për KKSB;
- Komuna e Shtërpçës duhet të bëjnë publikimin e të gjitha akteve të miratuara në kuvend në ueb faqet zyrtare në përputhje me Rregulloren Nr. 01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve komunale;
- Të shfrytëzohen mundësitë e konsultimeve paraprake me autoritetin mbikëqyrës;
- Komuna e Kllokotit të respektoj nenin 68 pika 1 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Kuvendi i Komunës së Gjakovës të dërgoj materialin e mbledhjes konform nenit 43.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Të hartohet programi i trajnimeve në 7 komuna (Mamushë, Malishevë, Partesh, Kamenicë, Gjakovë, Klinë dhe Leposaviq);

- Komuna e Leposaviqit të përgatitë Katalogun e vendeve të punës për Shërbimin Civil;
- Komuna e Leposaviqit dhe Zveçanit të themelojë Qendrën për shërbim të qytetarëve;
- Të jenë të qasshme hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit për personat me aftësi të veçanta, në 2 komuna ( Mitrovicë Veriore, Graçanicë dhe Gjakovë);
- Komunat Klinë, Leposaviq, Rahovec, Mitrovicë Veriore, Mamushë, Kamenicë, Klllokot, Hani Elezit, Partesh, Leposaviq dhe Zveçan të ndajnë buxhet për të financuar aktivitetet e OSHC-ve;
- Komunat Gjakovë, Shtime, Mamushë, Shtërpcë, Malishevë, Deçan, Suharekë, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Prizren, Hani Elezit, Klllokot, Dragash, Skenderaj, Junik, Mitrovica Veriore, Prishtinë, Kamenicë, Leposaviq, Zveçan dhe Kaçanik të hartojnë Planin e Lokal për Integritet;
- Komunat Novobërdë, Mamushë, Shtërpcë, Ferizaj, Deçan, Klinë, Rahovec, Pejë, Gjakovë, Vushtrri, Obiliq, Prizren, Viti, Hani Elezit, Klllokot, Glllogoc, Skenderaj, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Kaçanik, Mitrovicë, Leposaviq dhe Podujevë të caktojnë zyrtarin që raporton për zbatimin e Planit Lokal për Integritet;
- Komunat Deçan, Lipjan, Suharekë, Shtërpcë, Mamushë, Novobërdë, Rahovec, Ranillug, Gjilan, Prizreni, Klllokot, Dragash, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Prishtinë, Istog dhe Leposaviqi të hartojnë rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- Komuna e Ranillug, Mamushë, Mitrovica Veriore, Leposaviq dhe Zveçan të hartojnë rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare;
- Komunat Gjakovë, Ferizaj, Klinë, Shtime, Novobërdë, Shtërpcë, Mamushë, Ranillug, Dragash, Klllokot, Hani Elezit, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovicë Veriore, Prishtinë, Kamenicë, Mitrovicë, Partesh, Leposaviq dhe Zveçan të hartojnë Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore;
- Të funksionalizohen qendrat për promovimin e bizneseve në 15 komuna Vushtrri, Lipjan, Suharekë, Pejë, Ranillug, Mamushë, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Mitrovicë Veriore, Skenderaj, Partesh, Klllokot, Leposaviq dhe Dragash;
- Të bëhet modernizimi i mbledhjes së të hyrave në 7 komuna (Gjilan, Mamushë, Mitrovica Veriore, Hani Elezit, Leposaviq, Zveçan dhe Fushë Kosovë) për të përmirësuar mbledhjen e tatimit në pronë;
- Komunat Deçan, Gjakovë, Vushtrri, Peja, Suharekë, Klinë, Mamushë, Ranillug, Glllogoc, Hani Elezi, Skenderaj, Istog, Kamenicë, Leposaviq dhe Kaçanik të funksionalizojnë bazën e të dhënave personale;
- Komunat Mamushë, Shtërpcë, Ranillug, Klllokot, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Dragash, Leposaviq të hartojnë Planin për Eficiencë të Energjisë;
- Të miratohet Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komunitetit RAE në komunën e Novobërdës, Ranillug, Shtërpcë, Klinë, Rahovec, Pejë, Gjakovë, Shtime, Viti, Klllokot, Dragash, Zveçan, Fushë Kosovë, Junik, Graçanicë, Mitrovica Veriore dhe Leposaviq;



- Komunat (Novobërdë, Shtërpçë, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Klllokot, Kaçanik, Zveçan dhe Leposaviq të ndërmarrin aktivitete vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis;
- Komunat Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Mitrovica Veriore, Kamenicë, Leposaviq dhe Zveçan të hartojnë Planin e Menaxhimit të mbeturinave;
- Komunat Gjilan, Gjakovë, Vushtrri, Lipjan, Obiliq, Deçan, Rahovec, Pejë, Novobërdë, Mamushë, Prizren, Viti, Hani Elezi, Klllokot, Glllogoc, Prishtinë, Istog, Kamenicë, Mitrovicë, Podujevë, Fushë Kosovë, Skenderaj, Graçanicë, Leposaviq, Mitrovica Veriore dhe Partesh të hartojnë Planin për Menaxhimin e Tokave Rurale;
- Komunat Novobërdë, Mamushë, Shtërpçë, Malishevë, Rahovec, Klllokot, Kaçanik, Skenderaj, Graçanicë, Mitrovica Veriore, Partesh, Prishtinë, Fushë Kosova, Leposaviq dhe Zveçan të organizojnë trajnime për mbrojtjen dhe shëndetin e nënës dhe fëmijës.
- Komunat të shtojnë kujdesin në planifikimin e drejtë të të hyrave, duke shfrytëzuar mekanizmat përkatës ligjor dhe administrativ për rritjen e realizimit të tyre. Gjithashtu, komunat të bëjnë planifikime adekuate për rritjen e efikasitetit në shpenzimin e mjeteve buxhetore, e posaçërisht në kategorinë e investimeve kapitale.
- Komunat duhet të përmirësojnë menaxhimin e financave publike, në mënyrë që të të arrihen kriteret për marrjen e huas komunale.

Shtojcë 1: Shkeljet ligjore të cilat janë rishqyrtuar dhe janë harmonizuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Statuti Nr. 183 i Komunës së Rahovecit	Rahovec	Harmonizuar (31.03.2017)
Vendimi Nr. 28 sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim paraprak të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të parcelave Nr.P – 72217056 - 00493 – 0, dhe Nr.P – 72217056 – 00494 – 0. për personat fizik/juridik.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendimi Nr. 29 sipas propozimit të Kryetarit të Komunës për miratim paraprak të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër për parcelat kadastrale P-72217092-02816-2, certifikata e pronësisë Nr.13934-2017 me sipërfaqe të tërësishme prej 8 m2 për personat fizik/juridik.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendimi Nr.35 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë kompanisë Fitorja SH.P.K me Nr. 70410455 me pronarë Tahir Maloku.	Ferizaj	Harmonizuar 12.05.2017
Vendim për emërtimin e rrugëve në territorin e komunës së Glllogocit	Glllogoc	Harmonizuar 31.03.2017
Vendimi 01 Nr.26/2017 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës publike për 99 vite të njësisë kadastrale nr.750-0 ZK Gurrakoc-me qellim të ndërtimit të Kishës Katolike.	Istog	Harmonizuar 31.03.2017
Vendimi Nr.31-4836 për zgjedhjen e një anëtarit të KPF-së	Glllogoc	Harmonizuar

Shtojcë 2: Shkeljet ligjore të cilat nuk janë rishqyrtuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Vendimi Nr.430/17 për emërtimin e këshilltarit të kuvendit të komunës në komisionin për shqyrtimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve.	Graçanicë	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr. 060/01-504/1 për Dhënien në Shfrytëzim të Tokës Ndërtimore të Komunës së Dragashit.	Dragash	Nuk është rishqyrtuar
Vendim Nr. 060/01-504/2 për Dhënien në Shfrytëzim të Tokës Ndërtimore të Komunës së Dragashit.	Dragash	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi i kuvendit të komunës 01 Nr.V-6 për fillimin e procedurave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë (99) vite ne konkurs publik	Deçan	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01 Nr.65/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 5 hektarë nga njësia kadastrale Nr.28-1 në zonën kadastrale Cerrcë, PSHSH e mirë e fshatit për prodhimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.	Istog	Nuk është rishqyrtuar
Vendimi 01 Nr.66/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 56799 m <sup>2</sup> nga njësit kadastrale Nr.00077-79, 00077-77, 00077-76, 00077-72, kompleksi në vendin e quajtur “Mali i	Istog	Nuk është rishqyrtuar

Fshatit” zona kadastrale Lubozhdë, PSHSH e mirë e Shtetit, për prodhimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.		
Vendimi 01 Nr.68/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 6930m <sup>2</sup> nga njësia kadastrale Nr.74-6, sip.10356 m <sup>2</sup> njësia kadastrale 256, sipërfaqe 80695 m <sup>2</sup> njësia kadastrale 74-3, në zonën kadastrale Vrellë, PSHSH e mirë e fshatit, për prodhimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim.	<i>Istog</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim Nr. 8724/2 për shkeljen e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Nr.02/L-37.	<i>Kllokot</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim Nr. 8723/2 për shkeljen e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 neni 58 paragrafi (J).	<i>Kllokot</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Rregullore 15 Nr.011-52525 për Transparencë në Komunën e Lipjanit	<i>Lipjan</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Npi-255 për kompensimin e anëtarëve të komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike SH.A. “Pastërtia” në Ferizaj,	<i>Shtime</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim 01.Nr.I-5 mbi formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa	<i>Deçan</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr.400/787 për themelimin e KPF-së në Komunën e Glllogocit	<i>Glllogoc</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi nr.0601-266671/4, për zgjedhjen e nënkryetarit të komunës për komunitete	<i>Dragash</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim mbi formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa	<i>Lipjan</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim mbi formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa	<i>Fushë Kosovë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>

## Literatura/burimet

- MAPL: *“Raporti i Funksionimit të Komunave – periudha janar – dhjetor, 2017”*, MAPL, Prishtinë, 2018.
- MAPL: *“Raporti për Përbushjen e obligimeve të Agjendës Evropiane – periudha janar – dhjetor, 2017”*, MAPL, Prishtinë, 2018.
- MAPL: *“Raport lidhur me Opinionet e Auditimit për Komunitet e Republikës së Kosovës për vitin 2015 – 2016”*, MAPL, Prishtinë, 2017.
- MAPL: *“Raporti i Realizimit të të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2017”*, MAPL, Prishtinë, 2018.
- MAPL: *“Raporti i Shpenzimeve të Buxheteve Komunale për vitin 2017”*, MAPL, Prishtinë, 2018.
- Informata relevante të marra nga komunitet e Republikës së Kosovës, gjatë periudhës janar – dhjetor, 2017;
- Informata të siguruara nga komunitet me rastin e vizitave monitoruese në komunitet e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2017.